Biblioletra

REVISTË E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS

VITI 6 • NUMRI 2 • 2009

65-vjet të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës



DR. SALI BASHOTA,
DREJTOR I BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS

Historiku i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në këtë 65- vjetor, në radhë të parë, bëhet dokument i kohës për të përkujtuar datën e themelimit; pastaj periudhën e anatemimit, vitet e zhvillimit, etapat e ndërprerjes dhe, së fundi, epokën e ringjalljes së këtij institucioni qendror kombëtar. Prandaj, fjalët: datë, periudhë, vite, etapë dhe epokë, i riprodhojnë kuptimet e tyre, jo vetëm përbrenda sfondit simbolizues, por edhe ekzistencial në kohë dhe hapësirë të caktuar.

Dhjetori i vitit 1944 shënon fillimet e bibliotekarisë institucionale në Kosovë. Atëbotë ishte Prizreni, kryeqyteti i këtij vendi ku u themelua Biblioteka, e cila administrohej në rrethana të "pushtetit popullor", ndërsa tani në shekullin XXI është Prishtina, kryeqyteti i Republikës së Kosovës.

Sipas burimeve të ndryshme, historiku i bibliotekave në Kosovë daton nga periudhat e hershme, madje edhe në shekujt XIV-XV. Funksioni i këtyre bibliotekave ndërlidhej kryesisht me misionin e tyre përbrenda bashkësive të kultit.

/VIJON NË FAQEN 10/

ORGANIZOHET NË PRISHTINË EDICIONI I KATËRT I KONFERENCËS KOMBËTARE TË BIBLIOTEKONOMISË

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës bashkë me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë organizojnë, në Prishtinë, më 23 - 24 nëntor 2009, Konferencën Kombëtare të Bibliotekonomisë me temën: "Nga Bibliografia te Webografia e librit shqip".

Kjo Konferencë, tashmë tradicionale, e cila organizohet për herë të katërt, është organizim i përbashkët i këtyre dy institucioneve më të rëndësishme të bibliotekarisë (të Kosovës dhe të Shqipërisë) dhe mbahet nën kujdesin dhe mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës dhe Ministrisë së Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve të Shqipërisë.

Në këtë Konferencë, në të cilën pritet të paraqiten kumtesa nga njohësit më të mirë - me formim kulturor dhe bibliotekar, nga Shqipëria dhe Kosova, do të analizohen praktikat e gjertanishme si dhe të arriturat në punën e ruajtjes, përpunimit dhe bartjes së informacioneve bibliografike të librit shqip nga format tradicionale të botimeve në formatin libër, në plasimin, përkatësisht shpërndarjen e informacionit bibliografik të librit shqip nëpërmjet rrjetit të internetit.

Në këtë numër

TË NDERUAR MIQ KOSOVARË! 4

KATALOGIMI I FORMATEVE TË NDRYSHME NË UNIVERSITETIN NJU MEKSIKO 6

ASPEKTE TË BIBLIOTEKAVE DIGJITALE 13

DIGJITALIZIMI DHE NDIKIMI I TIJ NË KOLEKSIONET E VEÇANTA 16

BIBLIOTEKA KOMBËTARE NË SHTETIN E PAVARUR TË KOSOVËS 19

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KSOVËS
THE NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRARY OF KOSOVA

www.biblioteka-ks.org

Botues: BKUK • **Kryeredaktor i botimeve:** Prof. dr. Sali Bashota
Kryeredaktor: Fazli Gajraku
Këshilli redaktues: Besim Kokollari, Bukurije Haliti
Realizimi kompjuterik: Hekuran Rexhepi
Adresa: Sheshi "Hasan Prishtina", p.n. Prishtinë
Tel: ++381 38 225-605; **Fax:** ++381 38 248-940 • **e-mail:** biblioteka@biblioteka-ks.org

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË 2009

14-18 prill 2009, Prishtinë

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Ambasada Amerikane në Prishtinë, organizuan Edicionin e shtatë - Java e Bibliotekës në Kosovë 2009. Në këtë manifestim për Librin dhe Bibliotekat, që u mbajt në Prishtinë, Gjakovë dhe Ferizaj, më 14-18 prill 2009, u zhvilluan aktivitete të rëndësishme kulturore: ligjërata, promovime, donacione dhe përurime.

Në këtë edicion morën pjesë përfaqësues të njohur të bibliotekës e të kulturës nga Kosova dhe ShBA. Në ligjëratat e organizuara gjatë Javës, interesimin të madh të bibliotekarëve nga Kosova kanë zgjuar ato të Dr. Kenneth Oberembt, specialist për zhvillimin e bibliotekave nga SHBA, që mbahet mend në Kosovë si drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në vitin 2003, i cili hartoi planin strategjik për të ardhmen e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitarë të Kosovës. Ligjëratat e tij trajtuan tema që lidhen me kontekstin kosovar të zhvillimeve nga kjo fushë, duke dhënë ide dhe zgjidhje për shumë nga problemet që e preokupojnë stafin e bibliotekave në Kosovë.

Cikli i ligjëratave të tjera, të mbajtura nga bibliotekarë nga Kosova, po ashtu, ofroi kontribute të vyera në këtë fushë. Përmendim këtu ligjëratat e organizuara në Gjakovë me temën: "Biblioteka dhe shkolla", në të cilën referuan disa nga njohësit e kësaj problematike, si: Engjëll Berisha, Fatime Mehmetaj, Fatmir Pireci, Arjeta Sadiku, Lumnije Kasa, Shaban Shemsiu, Shqipe Shala dhe Adil Olluri.

Hapja solemne e Edicionit VII të Javës së Bibliotekës në Kosovë

Gjatë Javës u prezantua Programi i Automatizuar Bibliotekar Aleph 500 në Bibliotekën Ndërkomuale të Ferizajt. Komuna e Ferizajt tashmë ka dhënë mjetet për implementimin e këtij Programi dhe së shpejti rrjeti i këtij programi do të shtrihet edhe në këtë bibliotekë.

Nga aktivitetet promovuese, gjatë kësaj Jave, u shfaq filmi dokumentar kushtuar presidentit të parë afro-amerikan të SHBA-ve - Barack Obama. Me këtë rast Ambasada e SHBA-ve i dhuroi Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare librin "Guximi për të shpreshuar" të Barack Obamas.

Njëra nga aktivitet tashmë tradicionale në Javën e Bibliotekës në Kosovë është edhe Dita e Dhurimit të Librit, në të cilën shumë donatorë nga Kosova, i dhuruan Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës një sërë llojesh të materialeve, si: libra, revista, dorëshkrime, CD, DVD etj.

Në kuadër të Ditës së Dhurimit të Librit, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, i ka dhuruar 400 libra për Degën e bibliotekave të Vushtrrisë - fshatin Shtrojerë, si dhe 319 libra për Degën e bibliotekave të Besianës - fshatin Metehi.

Në edicionin e shtatë të Javës së Bibliotekës, është organizuar edhe ekspozita e librit të Qendrës së Bibliotekës Universitare dhe ekspozita e Periodikut shqiptar në BKUK (1945 - 2008).

Edhe ky edicion i Javës është kurorëzuar me të arritura që mund të përmirësojnë gjendjen e bibliotekave në Kosovë edhe nga pikëpamjet dhe konceptet që shtron stafi i bibliotekave, por edhe nga sensibilizimi që ky aktivitet është duke bërë në opinion dhe në institucionet qeveritare në përgjithësi, nëpërmjet dhënies së hapësirës për këtë aktivitet në mediat e shkruara dhe ato vizuale.

Përgatiti: Bukurije Haliti

TË NDERUAR MIQ KOSOVARË!



PROF. DR. TIHOMIL MAŠTROVIĆ,
Drejtor i Përgjithshëm i Bibliotekës Kombëtare edhe Universitare të Kroacisë

(Fjalimi përshëndetës i Drejtorit të Bibliotekës Kombëtare edhe Universitare të Kroacisë - Prof. dr. Tihomil Maštrović, me rastin e vizitës së tij në BKUK dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy bibliotekave kombëtare - të Kosovës dhe të Kroacisë)

Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Zagrebit dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, shpreh gëzimin tim të madh që me këtë akt është realizuar një lidhje shumë e rëndësishme kulturore në mes të shteteve tona. Kjo marrëveshje ka domethënie simbolike dhe profesionale letrare.

Më lejoni që së pari të flas për domethënien simbolike të këtij akti sepse në të marr pjesë jo vetëm si drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Zagrebit, por edhe si shkencëtar kroat.

Gjithsesi, nuk është më pak e rëndësishme as ajo se thelbi i kulturës sipas definicionit përcaktohet si simbolik, sepse fillon aty ku përfundon bota natyrore dhe krijohet ajo simbolike.

Bibliotekat kombëtare mishërojnë, përfaqësojnë, mbledhin dhe dokumentojnë me fjalë identitetin kombëtar kulturor dhe me përmbajtjen dhe veprimtarinë pasqyrojnë të gjitha aspektet e jetës kulturore por edhe luftën për integritet të territorit kombëtar.

Me vizitën e bërë Bibliotekës Kombëtare të Kosovës dhe vendosjen e bashkëpunimit, dëshirojmë të shprehim simpatinë tonë ndaj përpjekjeve të shtetit të ri të Kosovës për të krijuar lidhje të rëndësishme ndërkombëtare kulturore.

Gjithashtu, dëshirojmë të shprehim respektin ndaj viktimave të rëna për shtetin e Kosovës, sepse në atë drejtim edhe ne kemi përvoja të hidhura nga lufta çlirimtare e Kroacisë.

Me marrëveshjen midis dy bibliotekave, dëshirojmë që në rrafshin kulturor të bëjmë atë që Qeveria e Kroacisë e ka bërë në rrafshin politik, duke e pranuar shtetin e Kosovës, të cilit, mu sikurse Kroacisë, nuk i qe shkruar të shohë dritën e lirisë pa luftë të armatosur dhe pa humbje njerëzore dhe materiale.

Edhe pse shteti i Kosovës është pothuajse shteti më i ri në botë, si shtet me shumicë të popullit shqiptar, pra një prej popujve më të vjetër evropian, ai ka mbamendje shumëshekullore, jeton jo vetëm nga çastet aktuale dhe marrëdhëniet momentale të fuqive politike në skenën botërore politike, por në supozimet e veta kulturore ekziston aq sa ekziston një popull, jeton nga ajo qe Paul Riker e quan „ struktura të shtresuara“, të cilat si mbamendje kulturore krijojnë elementin ndërtues të një bashkësie kombëtare.

E para, për kulturën shqiptare, rrënjët e saj kulturore, e gjithsesi edhe para gërshetimeve të saj me kultura të tjera, një njohës i jashtëm i kulturës mund të mbetet thjeshtë i mrekulluar.

Me krenari mund të them se ky mrekullim i shoqëruar me simpati të veçantë, mund të vërehet posaçërisht në shkencën dhe kulturën kroate.

Kjo simpati nuk bën të anashkalohet, për këtë ndoshta do t'ju befasojë shkrimtari dhe intelektuali i nderuar kroat, Petar Shegedin.

Duke vëzhguar ngjashmërinë e fatit të popullit shqiptar dhe atij kroat, në një analizë subtile ai bën krahasime me qasjen romake ndaj Kartagjenës: *„Kartagjena është fajtore që ekziston“*, duke parafrazuar kështu esenë e mirënjohur të Katonit "*Ceterum censeo kartaginem delendam esse*".

Mendimi i Petar Shegedinit mund të ndiqet në të gjitha nivelet e tij të shumta, por gjithsesi vlen e vërteta se mbi popullin shqiptar dhe kroat deri vonë ka qëndruar pezull gjykimi i padrejtë sipas të cilit jemi fajtorë që ekzistojmë e edhe më fajtorë nëse dëshirojmë një vend tonin nën diell.

Ndoshta kjo është një prej arsyeve pse vërtet mund të flitet për albanologjinë kroate, shkencën mbi Shqipërinë dhe shqiptarët, por edhe mbi tematizimin letrar të Shqipërisë dhe shqiptarëve nga shkrimtarët kroatë.

Luftën e Skënderbeut kundër turqve e përshkruan si heroike qysh frat Andria Kačić - Miošić. Në ato gjurmë ka vazhduar edhe frati nga Bosnja, Lovro Mihačević, i cili pasi ka vepruar 40 vjet si prift katolik në mesin e shqiptarëve dhe ka qenë dëshmitar i krijimit të shtetit të Shqipërisë, pa pretendime shkencore, por disi si për shpirt të vetin ka shkruar dy libra mbi ta.

Në librin e dytë – *"Crtice iz albaneške povijesti"*, që në përkthim quhet „*Pjesë nga historia shqiptare*“, thotë: „*Se a do të qëndrojë Shqipëria e lirë dhe e pavarur, në çfarë hapësire dhe deri kur, këtë e di vetëm Zoti. Miqtë e popullit shqiptar i dëshirojnë atij fat"*. Kur është Kosova në pyetje, shumë kroatë u bashkëngjiten urimeve dhe dëshirave të tilla.

Me mburrje kujtoj se edhe babai im, dr. Vjekoslav Maštrović në literaturë përmendet si një prej atyre i cili si banor i Zarës ka kontribuar në studimet mbi arbanasit e Zarës.

Të shumtë janë autorët të cilët kanë studiuar bashkësinë arbanase në Zarë, në mesin e së cilave theksoj kontributin e çmueshëm të leksikografit dr. Kruno Krstić dhe sociologut të librit dr. Aleksandër Stipčević, si dhe ata që kanë studiuar klementinët, të cilit përfaqësojnë të ardhurit shqiptarë në fshatrat e Sremit, Hrtkovc dhe Nikinc.

Krahas shqiptarëve në Kroaci, edhe kroatët në Kosovë janë të rëndësishëm për të kuptuar historinë e popujve tonë.

Qysh nga shekulli i 14, ekziston bashkësia kombëtare kroate, janjevasit, ardhacakë me prejardhje nga Dubrovniku, të cilët e morën emrin sipas qytetit Janjevë, në afërsi të Prishtinës, ku jetojnë edhe sot e kësaj dite, megjithëse shumica e tyre janë kthyer në atdhe pas krijimit të shtetit të Kroacisë.

Fenë katolike edhe identitetin kroat kanë arritur ta rruajnë ndër shekuj. Një kroat i tejkalon të tjerët me kontributin e tij në marrëdhëniet kroato-shqiptare.

Ky është historiani kroat - i lavdishmi, Millan Shuflaj, i lindur saktësisht para 130 vitesh, një ndër themeluesit e albanologjisë.

Mendjendritur dhe poliglot, Shuflaj pjesën kryesore të energjisë së tij e investoi në studimet shkencore për Shqipërinë dhe shqiptarët, ndërsa nën pseudonim ka shkruar edhe disa vepra letrare me tematikë shqiptare.

Mendimin i tij për historinë e madhe të Shqipërisë nuk arriti ta realizojë, por studimet e tij mbi Shqipërinë arritën kulmin e shkencës evropiane.

Një nga studiuesit e jetës dhe punës të Shuflajit është edhe kroati kosovar, janjevasi Llazar Dodiċ. Ajo punë, pra interpretimi i Shuflajit për kulturën shqiptare dhe historinë e saj nuk i shkonte për shtati regjimit të atëhershëm serbomadh, kështu që Shuflaji u likuidua në vitin 1931 në rrugët e Zagrebit, para hyrjes së shtëpisë së tij. Agjentët policorë më pas hynë në shtëpinë e tij dhe morën me vete dorëshkrimin e tretë të përfunduar të "*Kodeks albanikus*". Kundër dorasëve nuk u zhvilluan hetimet.

Si mëkat i është mveshur gjithashtu edhe vetëdija kombëtare kroate, por edhe interesimi për historinë dhe kulturën e popullit shqiptar.

Të goditur me këtë vandalizëm politik, prijësit e shpirtit evropian Albert Einstein dhe Heinrich Mann, përmes lidhjes ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ftuan opinionin kulturor që të ngrihet kundër krimit të kryer mbi Milan Shuflajin, duke theksuar se vendet evropiane kanë për detyrë të vendosen si mburojë para popullit të vogël, por paqedashës dhe të ndritur kroat.

Por me këtë rast, si kurorë të përpjekjeve kroato-kosovare mund ta konsiderojmë rolin intelektual dhe kreativo-arkitektonik të arkitektit kroat Andrije Mutnjaković, i cili bart një shtytje të veçantë simbolike në sferën e bibliotekarisë.

Ai ka projektuar ndërtesën e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në Prishtinë (1982). Kontributi i tij domethënës në arkitekturën e qytetit të Prishtinës është edhe renovimi i ndërtesës së komandës turke, tash Muzeu i Prishtinës (1974).

Renovimi i ndërtesave ekzistuese dëshmon për vlerësimin e madh të Mutnjakovićit ndaj trashëgimisë ndërtimore.

Më shumë se kudo tjetër, Mutnjakovići e ka bërë këtë duke publikuar në gjuhën shqipe librin e vlefshëm mbi Andrij Alleshin, artistin e lindur në Durrës rreth vitit 1425, i cili ka vdekur në Split rreth vitit 1505.

Alleshi është vetëm një nga shqiptarët e shumtë, i cili me veprën e tij ka kontribuar në kulturën kroate si dhe me veprimtarinë e tij prej skulptori dhe ndërtimtari, dukshëm ka lënë gjurmë në renesancën artistike kroate, duke vepruar në disa qytete dalmatine.

Në fushën e bashkëpunimit profesional të bibliotekave, konturat themelore janë të theksuara në tekstin e marrëveshjes në mes të dy bibliotekave kombëtare.

Në zbatimin e marrëveshjes në fushën e furnizimit me material për biblioteka, gjithsesi duhet të përpiqemi që t'i zëvendësojmë ligjet e dikurshme të përbashkëta, ashtu që edhe ligjet për ekzemplarët e detyruar t'i kemi për shtetet tona, sot të pavarura.

Prandaj, do të duhej të merremi vesh rreth modaliteteve se si të arrihet që autorët shqiptarë, të cilët veprojnë apo kanë vepruar në Kroaci, të jenë të përfaqësuar në fondin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Kjo nuk do duhej t'i lihej improvizimit dhe vullnetit të mirë të institucioneve apo përpjekjeve individuale të autorëve.

E njëjta do të duhej të vlente edhe për autorët kroatë të cilët publikojnë veprat e tyre letrare dhe shkencore në Kosovë.

Prandaj, është gjithashtu e qartë se bashkërisht duhet të përpiqemi që kjo bibliotekë të ketë libra kroatë, përmbajtja e të cilëve i dedikohet Kosovës dhe janë të shkruar nga autorët kroatë dhe janë të publikuar në Kroaci dhe anasjelltas.

Kjo mund të zbatohet përmes shkëmbimit të planifikuar të materialit.

Papritmas është lajmëruar edhe mundësia e bashkëpunimit të frytshëm në rrafshin teknologjik.

Kjo ka të bëjë më Alephin - një pako programesh kompjuterike për përpunimin e materialeve të bibliotekës dhe afatizimin bibliotekar në përgjithësi.

Në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare në Zagreb, para disa vitesh, është blerë nga një kompani amerikane pakoja programuese vojazher.

Ai është treguar si joefikas në fushën e shenjave diakritike kroate.

Meqenëse, ndërkohë, vojazheri u bë pjesë e ofertës së kompanisë ExLibris, kjo na e ofroi pakon programuese Aleph, të cilën edhe e pranuam dhe tash punohet intensivisht në implementimin e atij programi në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare dhe Bibliotekat e Universitetit në Zagreb, me tendencë që të përhapet edhe në disa biblioteka të tjera universitare.

Në atë drejtim besojmë se do të na ndihmojë përvoja juaj disavjeçare me Aleph-in, si pako programuese me të cilën shërbehen edhe disa biblioteka kombëtare evropiane. Bashkëpunimi i bibliotekave me këtë do të fillojë në mënyrën më të mirë të mundshme profesionale, kështu që, pas nënshkrimit të marrëveshjes mbi bashkëpunimin e dy bibliotekave kombëtare, asaj kroate dhe kosovare, ia vlen që sa më parë të fillojë puna e ekspertëve në realizimin e formave konkrete të bashkëpunimit. Për këtë qëllim me mua kanë udhëtuar kolegët z. Krunoslav Rendulić, udhëheqës i Departamentit të Teknologjisë Informative në bibliotekën tonë, dhe Tajana Ljubičić, bibliotekare e sistemit, detyra e së cilës është shkëmbimi i përvojave me kolegët kosovarë në punën me pakon programuese Aleph. Në fund dëshiroj t'i falënderoj nikoqirët tanë kosovarë për mikpritjen e përzemërt dhe edhe një herë të theksoj se ushqej shpresa të mëdha për bashkëpunimin e dy bibliotekave tona kombëtare. Njëkohësisht theksoj se jam krenar që së bashku me ju jam bashkëpjesëmarrës edhe partner në këtë moment historik për shkëmbimin kulturor dhe bashkëpunimin e dy shteteve dhe popujve tanë.

A keni të bëni me metadata të mediave të ndryshme?

Katalogimi i formateve të ndryshme në Universitetin Nju Meksiko

Rebecca Lubas,

Drejtoreshë e Departamentit të Shërbimit të Katalogimit dhe Zbulimit të Informacionit, në Bibliotekën e Universitetit Nju Meksiko, Alburquerque, ShBA

(Ky artikull është shkruar për Kongresin e 75-të IFLA-s në Milano të Italisë që u mbajt më 23-27 korrik 2009. Përkthimi dhe botimi në gjuhën shqipe është lejuar nga autorja si dhe nga IFLA.)

ABSTRAKT

Ky artikull paraqet në mënyrë kronologjike se si po zhvillohet veprimtaria e Departamentit të Shërbimeve të Katalogimit dhe të Zbulimit të Informacionit të Bibliotekës së Universitetit Nju Meksiko (orig: New Mexico), duke dhënë shembuj specifik, prej një veprimtari kataloguese e përqendruar në burimet e shtypura në një veprimtari të gjerë që përfshin projekte të mëdha të katalogimit të materialeve audiovizuale. Duke e zhvilluar më tej bazën e njohurive për standardet dhe teknologjinë, si dhe duke e rritur fleksibilitetin në punë, Departamenti i Shërbimeve të Katalogimit dhe Zbulimit të Informacionit po krijon mundësi për zhvillimin e metodave të reja, më të shpejta dhe më të përshtatshme të procesit të punës.

HISTORIK I SHKURTËR

Katalogimi i materialeve audiovizuale filloi të bëhej në biblioteka si një përjashtim i çuditshëm, ku mbase një bibliotekari i caktohej detyra t'i katalogonte ato lloj materialesh në kohën e tij të lirë. Me rritjen e llojeve të ndryshme të formateve, mbase, kishte pastaj një person të caktuar, i cili bënte përshkrimin dhe klasifikimin e tyre. Mirëpo, tani jetojmë në një kohë ku numri i materialeve të pashtypura e ka tejkaluar numrin e materialeve të shtypura. Modeli i një kataloguesi të vetëm për katalogimin e "formateve të veçanta" nuk është më i përshtatshëm. Megjithëkëtë, bibliotekat ende janë të prira ta zhvillojnë veprimtarinë dhe punën e tyre si të ishin duke u marrë me materiale të shtypura. Ka ardhur koha për ndryshime kolosale në këto praktika.

Bibliotekat e Universitetit të Nju Meksikos kanë bërë ndryshime dramatike së voni. Për shkak të një zjarri në vitin 2005 dhe të një vërshimi në vitin 2006, pjesë të mëdha të koleksioneve u shkatërruan dhe më pas u zëvendësuan me materiale simotra elektronike. Përpjekjet për digjitalizimin e materialeve janë duke u shtuar, përfshirë këtu edhe një rregullore të re të vendosur nga Universiteti që i detyron të gjitha që t'i dorëzojnë në mënyrë elektronike punimet e tezave dhe disertacioneve, duke filluar prej semestrit veror të vitit 2009. Pensionimi i personelit, një riorganizim i bërë dhe largimet që ndodhën e lanë grupin e kataloguesve, në një anë një ekip me shumë përvojë, por në anën tjetër, një forcë tejet të vogël për t'u përballur me nevojat në rritje. Duhet theksuar, se tash e para një viti, veprimtaria e bibliotekave të këtij Universiteti ishte e orientuar kryesisht kah materialet e shtypura të mbështetura në standardet MARC/AACR2. Ndërsa, katalogimi i materialeve audio-vizuale bëhej në hapësira specifike në vend që të ishte një shërbim i shpërndarë gjithandej që procesi të ishte më efikas.

Në vitin 2008, grupi i katalogimit u reformua dhe mori emrin Shërbimet e Katalogimit dhe Zbulimit të Informacionit me një theks të veçantë në krijimin e metadatave për t'iu përshtatur sa më mirë mënyrës se si kërkojnë vetë përdoruesit. Ndërsa dihet mirë se përdoruesit e sotëm të bibliotekave nuk kërkojnë vetëm materiale të shtypura, madje edhe nuk e kanë prioritet të kërkojnë vetëm aso lloj materialesh. Ky riorganizim, dhe materialet, të cilat kishin nevojë për përkujdesje të ekspertëve të metadatave, kërkonte një vëmendje të vazhdueshme sa i përket aftësimit të kataloguesve, veprimtarisë dhe rrjedhës së punës brenda dhe jashtë seksionit, si dhe sa i përket zgjerimit të shpejtë të numrit të platformave elektronike në të cilat punohet në bibliotekë. Përderisa vetëm pak vite më

parë kataloguesit punonin në një bazë monolitike, e hartuar mbi bazën e një standardi po thuaj një dekadë të vjetër, tani ata mund të punojmë në një numër ambientesh e platformash të rrethuar prej një sërë standardesh nga më të ndryshmet. Në Bibliotekat e Universitetit të Nju Meksikos, shembujt nisin prej dhuratave të mëdha të disqeve zanore, të cilat më parë do të duhej të katalogoheshin nga një person i vetëm, deri te krijimi i arkivit digjital për një botues amerikano-jugor, i cili do të mund të kërkohej në bazë të përkthimeve paralele. Kjo mënyrë e punës kërkonte një vizion të ri. Kjo nënkupton se kontrolli bibliografik tashmë duhet të jetë shumëgjuhësh.

SHKATHTËSITË - NË DISPOZICION

Përkundër fatkeqësisë që i ndodhi Bibliotekave të Universitetit të Nju Meksikos, seksioni i katalogimit arriti të mbante rreth vetes talent të shkathë edhe pse në numër të vogël. Përveç përvojës me vite në krijimin e njësive kataloguese sipas standardeve të Rregullave anglo-amerikane dhe të formatit MARC (AACR2/MARC), kataloguesit e këtij seksioni ishin aftësuar, po ashtu, në praktikat e Programit të bashkëpunimit për krijimin e njësive autoriale (NACO), si dhe në standardet për zgjerimin e njësive kataloguese për materiale monografike të shtypura dhe për partitura.

Bibliotekat e Universitetit të Nju Meksikos kanë një koleksion të madh të materialeve në spanjisht dhe portugalisht, të cilat i mbështesin programet e studimeve Amerikano Latine në universitet. Disa prej kataloguesve i flasin këto gjuhë. Tani për tani, koleksioni në gjuhën ibero paraqet gati dy të tretat e furnizimeve tona me vepra të shtypura. Megjithatë, materialet audio-vizuale nuk janë të reja për kataloguesit tanë. Shumica prej tyre kanë punuar me vite me incizime zanore dhe me fotografi lëvizëse. Udhëheqësi i koleksionit të hartave, po ashtu, katalogon disa prej materialeve hartografike në atë koleksion.

VEPRIMTARIA E PUNËS

Bibliotekat e Universitetit të Nju Meksikos krahas orientimit primar të mbledhjes të versioneve elektronike të burimeve, ato ende mbledhin edhe libra dhe materiale në formë të shtypur. Mirëpo, librat nuk janë më i vetmi tregim tanimë i punës në katalogim. Shumica e librave vijnë tashmë të kataloguar dhe të gatshëm për t'u vënë menjëherë në raft, pasi që shitësi nga i cili blihen këto libra e ofron edhe këtë shërbim. Kështu që prej semestrit pranveror të vitit 2009, pothuaj dy të tretat e punës së përgjithshme në katalog ka të bëjë me incizimet zanore.

Në rregulloret e përzgjedhjes së revistave për Bibliotekat e Universitetit Nju Meksiko përcaktohet që versioni elektronik të blihet, nëse është në dispozicion, së bashku me qasje të qëndrueshme në numrat e mëhershme të tyre. Blerja e librave elektronik sa vjen e shtohet. Në këtë kontekst, bibliotekat po i përqendrojnë burimet, si të punës ashtu edhe të parave, në një sistem të menaxhimit dhe kërkimit të burimeve elektronike.

Deri vonë, tezat dhe disertacionet e doktoratave të krijuara nga studentët e Universitetit të Nju Meksikos përbënin një pjesë mjaft të madhe të punës në katalog. Për shembull, në prill të vitit 2009, 200 prej 500 titujve

të punës në katalog, të koleksioneve në gjuhët jo-iberike, ishin teza dhe doktorata. Në verë të vitit 2009, e tërë kjo do të ndryshojë, pasi Universiteti ka vendosur që të gjithë studentët në studimet postdiplomike t'i dorëzojnë punimet e tyre në formë elektronike në depoziturën digjitale të Universitetit të quajtur DSpaceUNM. Pra, nuk do të mblidhen më kopjet e shtypura. Këto teza dhe disertacione elektronike do të shoqërohen nga metadatat që i futin vetë autorët e tyre. Prandaj pa një plan të mirëfilltë, ato nuk do të shfaqen në procesin e katalogimit, siç është i rregulluar tani.

Një shembull tjetër i koleksioneve digjitale është "Abaya Yala". Këta tituj librash, nga botues të Amerikës Jugore, u ofrohen bibliotekave vetëm në formatin elektronik. Bibliotekat planifikojnë, si pjesë e marrëveshjes me botuesin, t'i depozitojnë ato në DSpace (Lexo: dispejs). Po qe se librat do të ishin në format të shtypur, ato lirshëm do t'i përshtateshin rrjedhës së tanishme të procesit të punës. Por, siç shihet nuk janë. Prandaj, pa një ndërhyrje konkrete ato do të mbesnin jashtë fushëveprimit të seksionit të katalogimit.

Kështu, duke marrë parasysh të gjithë talentin e kataloguesve të Universitetit të Nju Meksikos, dhe përvojën e tyre në katalogimin e materialeve audio-vizuale, ku qëndronte problemi?

Si në shumë biblioteka, edhe këtu, puna në katalogim ka mbetur e përqendruar kryesisht në materialet e shtypura, të organizuara rreth një gjuhe të metadatave, kryesisht në formatin MARC. Katalogimi i incizimeve zanore dhe i videove pothuaj bëhej në "izolim" prej materialeve të tjera. Kataloguesit e muzikës ishin të ndarë prej grupit kryesor të grupit të kataloguesve, dhe se kishin pak ose fare komunikim ose ndikim në diskutimet për rregulloret e katalogimit. Po qe se ata mbeteshin prapa në katalogim dhe rriteshin materialet e tyre të papërpunuara (gjë që kishte ndodhur për shkak të dhuratave të mëdha), ata duhej të gjenin zgjidhje vetë, pa marrë parasysh rritjes së vëllimit të punës. Aty këtu ofrohej ndonjë ndihmë nga grupi kryesor i kataloguesve, porse askush nuk i mbikëqyrte apo nuk i parashihte nevojat e tyre në mënyrë sistematike. Në seksionin kryesor të katalogimit, shumica e materialeve audio-vizuale i dërgoheshin për katalogim një kataloguesi. Nuk ishte ofruar ndonjë trajnim për kataloguesit e burimeve elektronike e lëre më ndonjë trajnim për standarde të tjera të metadatave, përveç formatit MARC.

BASHKIMI I TYRE

Rrjedha e procesit të punës paraqiste mundësi të trajnimeve të ndryshme. Posaçërisht paraqiste mundësi që kataloguesit të mësojnë prej njëri-tjetrit, e jo puna të kufizohej në një mësues, mbikëqyrës, apo orë mësimi.

Në vjeshtën e vitit 2008, kataloguesit e Bibliotekës së arteve të Bukura dhe Dizajnit iu bashkuan grupit kryesor të kataloguesve. Ata e mbajtën bazën e tyre gjeografike në Bibliotekën e Arteve të Bukura (ku kishin përgjegjësi të ofrimit të shërbimeve referale dhe të zhvillimit të koleksioneve), por u bënë pjesëmarrës aktiv në takimet dhe planifikimet e grupit të kataloguesve.

Duke marrë parasysh se kishim një furnizim të madh me incizime zanore, dukej praktike të shtohej grupi i kataloguesve për këtë lloj materiali. Njëri prej kataloguesve që mban përgjegjësinë kryesore për katalogimin e materialeve në gjuhët ibero është po ashtu edhe muzikant. Bibliotekës i ishin dhuruar afro 5000 disqe, të cilat duhej, si të vlerësoheshin, ashtu edhe të katalogoheshin. Kataloguesi i muzikës, si dhe kataloguesi 'i ri' me përvojë muzikore u takuan dhe e sajuan një plan të përpunimit të këtij materiali në dy vende të ndryshme. Kataloguesi i ri, i cili do t'i ndihmonte kataloguesit të muzikës, e mësoi shpejt punën, duke u mbështetur në përvojën e tij të gjatë me parimet e përgjithshme të katalogimit dhe në dijen e tij personale për muzikën. Pas gjashtë muajsh, këtij grupi iu shtua edhe një katalogues tjetër. Ky katalogues kryesisht ishte përgjegjës për katalogimin e materialeve audio-vizuale të zhanreve të tjera, përveç të muzikës, sidomos të katalogimit të videove, si dhe kishte kataloguar më parë incizime zanore. Ky shkëmbim njohurish kishte efekt të dyanshëm. Pra, kur kishim grumbullim të materialeve në gjuhët ibero, kataloguesit e Bibliotekës së Arteve të Bukura e jepnin ndihmën e tyre në katalogimin e librave në spanjisht dhe portugalisht që trajtonin tema të artit. Kjo mënyrë e rrjedhës së procesit të punës u ka ndihmuar Bibliotekave të Universitetit të Nju Meksikos t'i caktojë kataloguesit aty ku lypset nevoja.

Kur tezat dhe doktoratat të bëhen vetëm elektronike, kataloguesit nuk do të marrin ndonjë paralajmërim se ka mbërritur një deng i shtypur i dorëshkrimeve. Për t'u përgatitur për këtë situatë të re janë rishikuar metadatat Dublin Core (lexo: dablin korë) në DSpace me kundrejt një grupi të tezave dhe doktoratave të dorëzuara në mënyrë vullnetare nga studentët në tri vjetët e fundit. Gjatë këtij procesi na doli se, përveç përmbajtjes së dobishme të abstrakteve dhe fjalëve kyçe që ndodheshin, metadatat duhej të rregulloheshin sa u përket njësimit të emrave dhe lëndëve. Një frikë tjetër ishte se po të zgjeroheshin elementet e metadatave në DSpace do të bëhej një ndarje e koleksioneve në katalogun e bibliotekave mes punimeve të viteve para vitit 2009 dhe titujve të rinj në këtë depoziturë elektronike. Po ashtu,

po punohet që të krijohen mekanizma paralajmërues për kataloguesit kur të bëhen dorëzime të reja të punimeve në DSpace, me qëllim që kataloguesit të mund t'i zgjerojnë e pasurojnë metadatat, dhe pastaj në fund t'i bashkojnë me metadatat në formatin MARC, me destinim të fundit të integrimit të tyre në Katalogun Botëror (WorldCat) të OCLC-së, si dhe të Katalogut të Përbashkët të Bibliotekave të Universitetit të Nju Meksikos.

Koleksioni i titujve "Abya Yala", i cili u përmend më parë, do të futet në DSpace po ashtu. Kjo do t'ju jep më shumë përvojë praktike kataloguesve të gjuhëve iberike në dorëzimin e punimeve në depozitarë, duke i përdorë metadatat Dublin Core, si dhe elementet bashkëtakuese të tyre me formatin MARC. Kjo do të bëhet për arsye që këta tituj të mund të kërkohen si nga depozitura, ashtu edhe nga WorldCat dhe Katalogu i Bibliotekave të Universitetit.

Përveç të mësuarit të formateve të reja, gjuhëve të metadatave, si dhe mënyrës së punës, ia vlen të shënohet edhe ky ndryshim në rrjedhën e procesit të veprimtarisë kataloguesve në Bibliotekat e Universitetit Nju Meksiko. Prekja e secilit titull me dorë me qëllim të përpunimit sa më të hollësishëm të metadatave nuk është më një qasje praktike, duke parë trendin e përhapjes së shpejtë të informacionit. Kataloguesit mund dhe duhet t'i zbatojnë shkathtësitë për të importuar dhe manipuluar lloje të ndryshme të metadatave që koleksionet e bibliotekave të jenë sa më të hapura për kërkim. Në Universitetin e Nju Meksikos po punohet në një projekt për t'i marrë të plota dhe të gatshme metadatat për revistat elektronike, që kërkon përzgjedhjen e një shitësi, testimin e të dhënave, dhe raportimin e të dhënave, të cilat nuk përkojnë me titujt e revistave në koleksionet e Bibliotekës. Përderisa kataloguesit ta zbatojnë dijen, sa i përket standardeve të metadatave në këtë proces, ata po ashtu do të zhvillojnë shkathtësi të reja. Pra, shkathtësi të menaxhimit të projekteve. Kur kataloguesit krijojnë njësi kataloguese, tani theksi bie në pasurimin e metadatave për tërë botën (përmes WorldCat të OCLC-së), e jo vetëm i pasurimit ose redaktimit të metadatave në katalogun e Universitetit të Nju Meksikos.

Kjo botë e informacionit u jep kataloguesve, po ashtu, mundësi për të punuar përtej bibliotekave. Universiteti i Nju Meksikos ka futur në përdorim një vegël të kërkimit të Google, që mundëson kërkimin e faqeve të internetit të Universitetit. Në vitin 2009, Bibliotekat e këtij universiteti kanë shprehur interesin për të luajtur një rol më të madh në menaxhimin e kësaj vegle. Kataloguesit do ta huazojnë ekspertizën e tyre për ta përmirësuar mënyrën e kërkimeve të faqeve të Universitetit Nju Meksiko, duke u këshilluar me departamentet që kanë zhvilluar praktika të mira në metadata dhe dizajn të faqeve të internetit.

PËRFUNDIM

Zgjerimi i formateve të informacionit nuk paraqet "pak a shumë gjënë e njëjtë" për kataloguesit. Ajo paraqet mundësinë e zbatimit të shkathtësive të organizimit të informacionit në mënyra të reja. Në Universitetin Nju Meksiko, po shfrytëzohet kjo mundësi për t'u bërë më fleksibil në caktimin e punëve për katalogues dhe në arritjen e rezultateve më të mira të kërkimit nga përdoruesit tanë, pa marrë parasysh nëse e përdorin katalogun e bibliotekës, depoziturën digjitale, ose thjeshtë e vizitojnë ndonjërën prej ueb-faqeve të Universitetit. Mbajtësi i informacionit nuk duhet të paraqet problem; qasja në përmbajtje duhet të jetë e barabartë.

PËR AUTOREN

Rebecca L. Lubas është drejtoreshë e Departamentit të Shërbimeve të Katalogimit dhe Zbulimit të Informacionit në Bibliotekat e Universitetit të Nju Meksikos, ku e koordinon një grup të kataloguesve të cilët punojnë në formate të ndryshme. Para se të vijë në Universitetin Nju Meksiko në vitin 2008, Rebecca ishte në Bibliotekat e Institutit të Teknologjisë së Masaçusets (MIT), si Shefe e Shërbimit të Katalogimit dhe të Metadatave, si dhe Kataloguese e Formateve të Veçanta.

Si bibliotekare e Katalogimit të formateve të veçanta në MIT, Rebecca ishte përgjegjëse për katalogim origjinal të burimeve monografike audio-vizuale, si dhe për aftësimin e kataloguesve për formatet audio-vizuale. Rebecca ishte anëtare themeluese e Departamentit të Shërbimeve të Metadatave në Bibliotekat e MIT-së. Para se të vinte në MIT, Rebecca ishte kataloguese e periodikut dhe materialeve audio-vizuale në Universitetin Shtetëror Ball (Ball State University).

Në vitin 2005, Rebecca ishte kryetare e Shoqatës së Kataloguesve Audiovizual (Online Audiovisual Catalogers) dhe ka paraqitur kumtesa në seksione të ndryshme të Shoqatës së Bibliotekave Amerikane. Në vitin 2006, ajo ishte ligjëruese speciale në Javën e Bibliotekës në Kosovë. Rebecca mban titullin: magjistër në Letërsi Angleze nga Universiteti Shtetëror Ball, dhe një titull tjetër të magjistrit në Shkencat e Bibliotekarisë dhe të Informacionit nga Universiteti Shtetëror i Luizianës, ndërsa është e diplomuar nga Universiteti i Notre Damit.

Përktheu nga anglishtja
Besim J. Kokollari

65-vjet të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës

/ VIJON NGA FAQJA E PARË /

Themelimi i institucionit të parë bibliotekar dhe zhvillimi i bibliotekave në Kosovë, gjithsesi, pikë referimi e kanë Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, e cila ka kaluar periudha të vështira me përballje të shumta, madje duke marrë emërtime të ndryshme: Biblioteka Regjionale e Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë (1944-1952), Qendra Bibliotekare e Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë (1956-1961), Biblioteka Popullore Krahinore (1961-1970), Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës (1970-1990), Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës e Metohisë ((1990-1999), ndërsa nga viti 1999-Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës.

Ndërtesa e tanishme e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës u inaugurua më 25 nëntor 1982. Hapësira e saj përfshin 16.500 metra katrorë. Është e përbërë me dritare zenitale, me gjithsej 99 kupola, të cilat e kanë simbolikën e vet të veçantë arkitekturale.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës është institucioni bibliotekar qendror i Kosovës dhe qendër e informacionit bibliotekar në nivel kombëtar. Misioni i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës është i ngjashëm sikundër i bibliotekave të tjera kombëtare në shtete të ndryshme të botës, edhe si anëtare në institucione të ndryshme ndërkombëtare.

Me rrënimin e pozitës kushtetuese të Kosovës në vitin 1989, veprimtaria bibliotekare, sikundër edhe në sferat e tjera në kulturë, arsim e shkencë, u diskriminua nga pushteti serb. Periudha e viteve 1998-1999 është periudha e okupimit dhe e inkuizicionit, pra e shkatërrimit, zhdukjes dhe e djegies së koleksioneve bibliotekare në shumë biblioteka publike dhe private në Kosovë.

Nga viti 1990 deri në vitin 1999 në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës pushteti okupues serb aplikoi masat e dhunshme, duke i larguar punëtorët shqiptarë nga puna, si dhe duke ua mohuar të drejtën lexuesve shqiptarë për shërbime. Pos që ishte mbushur me refugjatë serbë nga Kroacia dhe Bosnja, në periudhën mars-maj 1999, gjatë ndërhyrjes së NATO-s, ndërtesa e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës ishte shndërruar si vendqëndrim i ushtrisë serbe.

Gjithashtu, në periudhën e administrimit serb, Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës i janë shtuar 22.000 libra, të gjitha në gjuhën serbe dhe asnjë në gjuhën shqipe, ndërsa po në këtë periudhë 100.000 libra në gjuhën shqipe, të cilat kanë qenë të destinuara për shkëmbim dhe dhurim janë zhdukur nga administrata e dhunshme e këtij institucioni, madje duke u shndërruar në kartuç letre. Po kështu, në periudhën e pushtimit, në këtë institucion është bërë edhe një spastrim i madh i koleksioneve me vlerë kombëtare, sidomos i veprave të autorëve të traditës shqipe.

Sipas të dhënave nga revizioni i koleksioneve bibliotekare në vitin 2004, koleksionet e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës numëronin 1.890.194 njësi bibliotekare, me 475.324 tituj, nga të cilat: libër: 382.806 njësi; revista: 281.591 njësi; gazeta: 984.022 njësi dhe botime të tjera: 241.775 njësi. Nga viti 2004 deri në tetor 2009, pasurimi i fondeve bibliotekare në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës përmes ekzemplarit të detyrueshëm, blerjes dhe dhuratave është rritur edhe mbi 30.000 tituj të rinj.

Në kuadër të zhvillimit të veprimtarisë së saj në përgjithësi, BKUK në gjirin e vet i ka edhe disa mini-biblioteka: Biblioteka e Këndit Amerikan, Biblioteka e Artit Bashkëkohor, Biblioteka e NATO-s, Biblioteka Muzikore, Biblioteka Europiane, Biblioteka legatë e Fehmi Aganit, Biblioteka legatë e Krist Malokit, Arkivi i Autorëve etj. Këto mini-biblioteka me fondet e tyre të pasura janë dhuratë nga institucionet ndërkombëtare dhe vendore, si dhe nga individë, kështu që koleksionet e tyre të shumëllojshme, të cilat janë në gjuhë të mëdha të botës, ofrojnë informacione me interes për përdoruesit dhe specialistët e fushave të veçanta.

Qendra dokumentare Kujtesa e Kosovës, e cila është themeluar në vitin 2008, me synim për t'i ngjasuar zhvillimit të portalit Kujtesa Amerikane (American Memory), është njëri ndër projektet më të rëndësishme që ka të bëjë me identitetin e Kosovës. Hulumtimi, grumbullimi, përzgjedhja, sistemimi i materialeve që kanë të bëjnë me Kosovën, dhe, më në fund, digjitalizimi i tyre është njëri ndër projektet më të mëdha që synohet në të ardhmen. Gjithsesi, Kujtesa e Kosovës do të kontribuonte në realizimin projektit e përbashkët Kujtesa Shqiptare, i cili është synim i dy bibliotekave kombëtare, të Shqipërisë dhe Kosovës.

Fondet e librit të rrallë e të vjetër, pastaj të koleksioneve të gazetave dhe revistave të vjetra, të dorëshkrimeve shqipe me grafi latine, arabe dhe greke, janë një thesar i çmuar i trashëgimisë kulturore që e ka ky institucion. Gjithashtu, edhe hartat, fonodokumentet, fotodokumentet e materiale të tjera të vlefshme paraqesin një pasuri të madhe kulturore, ndërsa shërbimi i restaurimit dhe i konservimit të materialit bibliotekar në BKUK tashmë ofron cilësinë moderne të veprimtarisë së tij.

Libri më i vjetër në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovë është "Historia e jetës dhe bëmave të Skënderbeut, Princit të Epirotëve", i



autorit Marin Barleti, përshkruar në gjuhën latine, i cili është përkthyer gjermanisht nga Johan Piniciani, botuar në Augsburg në vitin 1533. Ky libër është dhuratë për BKUK-në nga Patricia Nugee, koleksionuese e njohur angleze e veprave të Skënderbeut.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka në përdorim programin e automatizuar bibliotekar Aleph 500, njërin ndër programet më të avancuara në botë në fushë e bibliotekave, i cili është në përdorim në më se 50 shtete të botës, me një shtrirje të madhe, sidomos në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. BKUK e ka blerë këtë program nga kompania Ex Libris, me seli në Londër. Që nga viti 2005 përmes këtij sistemi të automatizuar bibliotekar deri më tani katalogimi elektronik është bërë 37.000 njësive bibliografike, apo 90.000 njësive fizike.

Programi Aleph 500, përveç në BKUK, funksionon edhe në dy biblioteka ndërkomunale, në Prishtinë dhe Prizren, ndërsa parashihet të shtrihet edhe në të gjitha bibliotekat kryesore në Kosovë, në mënyrë që të krijohet katalogu përmbledhës i materialeve bibliotekare, që do të ishte njëri nga projektet më të rëndësishme në modernizimin e bibliotekarisë, i cili do t'u ofronte lexuesve informacione të shpejta e të sakta për koleksionet bibliotekare në përgjithësi.

BKUK duke qenë institucioni qendror kombëtar i bibliotekarisë në Kosovë ka dhënë një kontribut të vazhdueshëm edhe në aftësimin profesional në bibliotekat e Kosovës. Gjithashtu, pasurimi i koleksioneve të bibliotekave të ndryshme në Kosovë nga fondi rezervë i BKUK-së në periudhën 2001-2009 është 41.000 ekzemplarë. Edhe themelimi dhe riaktivizimi i shumë bibliotekave të reja ka qenë dhe do të jetë njëri ndër synimet kryesore të strategjisë së zhvillimit të bibliotekarisë në Kosovë edhe në të ardhmen.

BKUK është bashkëthemeluese e dy manifestimeve të rëndësishme kulturore për librin dhe bibliotekat. Manifestimi ndërkombëtar "Java e Bibliotekës në Kosovë", i themeluar bashkë me Ambasadën e SHBA-ve në Prishtinë në vitin 2003, tashmë është shndërruar në një institucion më vete, pikërisht sa i përket rezultateve dhe sukseseve në ofrimin e modeleve më të mira amerikane, por edhe evropiane në zhvillimin e bibliotekarisë sipas standardeve më të avancuara ndërkombëtare. Manifestimi i dytë me karakter kombëtar "Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë", i themeluar bashkë me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë në vitin 2006, është, gjithsesi, treguesi tjetër i rëndësisë së veçantë shkencore në zhvillimin e bibliotekarisë së Shqipërisë dhe Kosovës në shumë drejtime.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës përmes Konsorciumit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës ofron qasje në burimet më të njohura elektronike në botë. Në fillim, shërbimet për burimet elektronike në biblioteka janë mbështetur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur deri në gjysmën e dytë të vitit 2005, ndërsa nga periudha e viteve 2006-2009, qasja në bazën e të dhënave në këto burime elektronike është bërë përmes kompanive EBSCO dhe GALE , me mbështetje financiare nga Ambasada Amerikane në Prishtinë. Burimet elek-

tronike të OXFORD Scholarship Online dhe Oxford Jurnals, janë mbështetur nga OSBE-misioni në Kosovë, ndërsa Oxford Music Online nga Raiffeisen Bank në Kosovë. Përdoruesit e këtyre burimeve elektronike në fusha të ndryshme të shkencës kanë qasje në librat elektronikë dhe në revistat elektronike më të njohura në botë.

BKUK që nga viti 2004 e boton revistën profesionale "Biblioletra". Kjo revistë sjell informacionin më të plotë për zhvillimin e BKUK-së , si dhe të bibliotekarisë së Kosovës në përgjithësi. Kjo revistë, gjithsesi, është bërë tribunë e mendimit të ekspertëve për afirmimin e bibliotekarisë së Kosovës dhe të përvojës së tyre në këtë drejtim. Gjithashtu, në fushën e botimeve, BKUK deri më tani ka botuar mbi 60 libra e botime tjera të ndryshme profesionale, origjinale dhe të përkthyera, dhe në këtë drejtim është ofruar dija më e avancuar në shkencat e bibliotekarisë bashkëkohore.

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, BKUK, përveç se është njëra ndër themelueset e Unionit të Bibliotekave të Ballkanit në vitin 2009 në Edirne të Turqisë, është anëtare e organizatave të ndryshme në nivel ndërkombëtar. BKUK është agjenci e ISBN-së për botimet e librit në Kosovë , agjenci e ISMN-së për botimet muzikore në Kosovë, pastaj anëtare e eIFL.net. Ky institucion ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shumë biblioteka kombëtare, institucione, kulturore, shkencore, arsimore etj. Ka bashkëpunim me Bibliotekën e Kongresit në SHBA, pastaj me biblioteka të ndryshme në Francë, Zvicër, Poloni, Rumani, Gjermani, Turqi, Angli, Kroaci, Maqedoni, po ashtu edhe me bibliotekat e rajonit të Ballkanit. Në gusht të vitit 2009 BKUK është pranuar anëtare e rregullt e Konferencës së Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare të Botës. Gjithsesi, bashkëpunimi gjithnjë e më i frytshëm me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë është kaptina më e veçantë e rezultateve dhe sukseseve të BKUK-së.

Historiku i BKUK-së në këtë 65-vjetor, ndërlidhet edhe me veprimtarinë bibliotekare, e cila zhvillohet në bibliotekat ndërkomunale në Kosovë, të cilat konsiderohen si biblioteka të nivelit të dytë. Këto biblioteka funksionojnë në qendrat më të mëdha të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Leposaviq, ndërsa bibliotekat komunale në qytete më të vogla të Kosovës konsiderohen si biblioteka publike të nivelit të tretë.

Në vitet 1998-1999 në bibliotekat publike dhe private në Kosovë janë zhdukur dhe djegur me mijëra koleksione bibliotekare. Sipas burimeve vendore dhe ndërkombëtare, vetëm në 183 biblioteka në Kosovë ndërmjet viteve 1990-1999 kanë humbur apo janë asgjësuar afër 1.000 000 ekzemplarë të botimeve të ndryshme.

Veprimtaria bibliotekare në Kosovë zhvillohet edhe në institucione të tjera shkencore, arsimore, siç janë: Biblioteka e Akademisë së Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Biblioteka e Institutit Albanologjik të Prishtinës, bibliotekat e fakulteteve të Universitetit të Prishtinës, pastaj bibliotekat shkollore etj..

Libri dhe bibliotekat në Kosovë kanë kaluar nëpër periudha të ndryshme të zhvillimit dhe të ndërprerjes. Faktet dhe dëshmitë tregojnë për fazat e zhvillimit dhe të afirmimit normal të veprimtarisë botuese dhe bibliotekare, por edhe për fazat e diskriminimit dhe të okupimit, duke filluar sidomos nga vitet 80-ta të shekullit XX e deri në vitin 1999.

BKUK në periudhën e viteve 2003-2009 është mbështetur me një përkushtim të veçantë nga Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë. Ky kontribut është dhënë për Këndin Amerikan në BKUK, për shkollimin e punëtorëve të BKUK-së në SHBA, për themelimin e Qendrës së Bibliotekës Universitare në kuadër të BKUK-së, për manifestimin ndërkombëtar "Java e Bibliotekës në Kosovë", për financimin e burimeve elektronike, për modernizimin e Bibliotekës së Skenderajt, si dhe për realizimin e shumë projekteve të tjera. Gjithashtu, Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë duke e ftuar Dr. Kenneth Oberembt në Kosovë, i cili ishte Drejtor i Përkohshëm i BKUK-së në vitet 2002-2003, ka dhënë kontribut të pakursyer në zhvillimin e këtij institucioni.

Kontribut të çmuar kanë dhënë edhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Europian (OSBE) -misioni në Kosovë, për përmirësimin e cilësisë në edukim, me pajisje kompjuterike si dhe me financimin e burimeve elektronike, pastaj Fondacioni Transfair nga Zvicra për pajisjen e zyrave të BKUK-së, Raiffeisen Bank për themelimin e Bibliotekës Muzikore me investime në infrastrukturë dhe burime elektronike, iniciativa e artistëve gjermanë për themelimin e Bibliotekës së Artit Bashkëkohor, si dhe shumë institucione e individë të tjerë, të cilët kanë kontribuar me dhurimin e fondeve me vlerë.

Është më rëndësi të thuhet se bibliotekaria e Kosovës dhe sistemi universitar i këtij vendi, ka nevojë për një degë të bibliotekarisë. Gjithsesi, automatizimi dhe modernizimi i shërbimeve bibliotekare në Kosovë, krijimi i rrjetit unik të librit shqip, pastaj anëtarësimi në institucionet më të larta të bibliotekarisë në nivel ndërkombëtar, si dhe themelimi i Bibliotekës Digjitale të Kosovës, janë ndër synimet kryesore për Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare e Kosovës në të ardhmen.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë nën autoritetin e së cilës është BKUK, e ka mbështetur zhvillimin e këtij institucioni me shumë projekte kapitale, ndërsa Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e ka mbështetur reformimin dhe modernizimin e shërbimeve që ofron institucioni ynë, përmes teknologjisë së re të komunikimit dhe të qasjes së lirë në burimet e informacionit.

Në këtë 65-vjetor, urojmë që BKUK dhe institucionet e tjera bibliotekare në Kosovë, edhe më fuqishëm të jenë në shërbim të edukimit, shkencës, kulturës. Gjithsesi, vizioni apo projekti i së ardhmes së tyre le të jetë udhëtim i sigurt në bibliotekarinë bashkëkohore të shekullit XXI.

Aspekte të Bibliotekave Digjitale

Besim J. Kokollari

(Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës)

ABSTRAKT

Në këtë artikull bëhen përpjekje minimale të qartësohen koncepte të ndryshme të bibliotekave digjitale. Gjithashtu, jepen në mënyrë të thuktë disa aspekte të cilat duhet të kihen parasysh në rast të krijimit apo ndërtimit të një biblioteke digjitale të çfarëdo shkalle. Këtu shtjellohen shkurtimisht aspektet të teknologjisë, personelit, qeverisjes dhe administrimit, zhvillimit të koleksioneve, ruajtjes dhe konservimit, si dhe rëndësisë së financimit të qëndrueshëm, duke i futur ato në vijat buxhetore të institucionit amë. Autori tërheqë vëmendjen se për ta arritur të ardhmen duhet të ndërtohet e sotmja, duke aluduar në nevojën e krijimit të bibliotekave digjitale për të forcuar dhe ndërtuar të ardhmen e bibliotekave të Kosovës.

Fjalë kyçe: Biblioteka digjitale; Zhvillimi i koleksioneve; Ruajtja; Administrimi i bibliotekave digjitale.

HYRJE

Në përgjithësi në Kosovë jo vetëm që shkruhet por edhe flitet pak për bibliotekat digjitale. Madje, ato shihen si të largëta dhe të paarritshme. Ndërkaq, trendët zhvillimore tregojnë se shërbimet më të mëdha do të mbështeten në një platformë digjitale apo elektronike. Për shembull, varësinë që secili prej nesh kemi krijuar ndaj internetit. Andaj, orientimi kah krijimi dhe zhvillimi i tyre në Kosovë duhet të jetë një ndër prioritetet, pasi ato janë edhe të kapshme edhe të arritshme.

Megjithatë, edhe pse pa biblioteka digjitale, shumë nga bibliotekat e Kosovës tashmë janë të përfshira dhe të orientuar me vetëdije ose pavetëdije kah to. Kjo ndodh për shkak të shfrytëzimit të teknologjisë informative dhe internetit, qoftë përmes uebfaqeve, postave elektronike, programeve të komunikimit të atypëratyshëm, shfrytëzimit të burimeve elektronike të blera e të abonuara, burimeve të hapura të internetit, e madje disa edhe me automatizimin e shërbimeve të tyre. Kur është fjala te automatizimi, shpesh ai përdoret për të nënkuptuar digjitalizimin. Natyrisht, se janë të ndërlidhura, por secila prej tyre paraqet aspekte të veçanta të bibliotekave digjitale. Përderisa me "automatizim" kryesisht nënkuptojmë organizmin dhe paraqitjen e dokumenteve të shtypura përmes metadatave, pra përshkrimit bibliografik, në formë elektronike dhe kryerja e një varg shërbimesh me to. Me "digjitalizim" duhet të nënkuptohet konvertimi i materialeve të shtypura në format digjital duke përdor aparate të skanimit e fotografimit që mundësojnë jo vetëm shfaqjen e tyre në kompjuter, por edhe manipulimin e indeksimin e tyre. Në këtë kontekst, bibliotekat digjitale përfshijnë koleksionet digjitale, një varg shërbimesh të ndryshme për përdorues, bibliotekarë, teknologji për organizimin dhe shfaqjen e dokumenteve, rregulla dhe parime mbi të cilat mbështetet puna e tyre, mbështetje financiare. Pra, shikuar nga ky këndvështrim, bibliotekat digjitale mund të konsiderohen edhe si institucione, herë të krijuar në kuadër të një institucioni tjetër, e herë të varura nga një numër institucionesh.

Bibliotekat digjitale duhet t'i përvetësojnë mësimet nga bibliotekat tradicionale. Me këtë nënkuptojmë organizimin e informacionit, kryerjen e shërbimeve të ndryshme, praninë e bibliotekarëve në forma të ndryshme për të ofruar shërbime në pajtim me realitetin e ri digjital. Po të sjellim ndërmend 'bibliotekat', ato na kujtojnë një vend ku ka libra, gazeta, revista, fotografi, etj., të organizuara mirë, dhe ku ka bibliotekarë të cilët të ndihmojnë në gjetjen e informacionit të duhur. Të njëjtën gjë duhet bërë edhe me bibliotekat digjitale të pranishme kryesisht përmes internetit. Pra, biblioteka digjitale duhet të ketë informacione të llojeve të ndryshëm, ato duhet të organizohet, duhet të ofrohen shërbime të ndryshme përmes pranisë së bibliotekarëve duke shfrytëzuar mjete të ndryshme të komunikimit si, përmes postës elektronike, programeve të komunikimit të aty-përatyshëm, pjesëmarrjes në forume, videoparaqitjeve, e formave të tjera që ofron interneti, përfshirë edhe ato automatike.

Ndoshta, shumicës prej nesh u ndodh të dërgojmë letra përmes postës elektronike, të skanojmë një dokument dhe t'ia dërgojmë atë përdoruesit, të shfrytëzojmë burimet elektronike për ta kryer një shërbim referal, madje edhe të kërkojmë edhe të bëjmë huazim ndërbibliotekar të materialeve elektronike me ndonjë bibliotekë jashtë vendit. Pra, në kontekste të caktuara, me një varg shërbimesh dhe burimesh elektronike, me shërbime të automatizuara, me bibliotekarë të aftë të përdorin teknologjinë e informacionit për të kryer shërbime bibliotekare, kemi të bëjmë me një bibliotekë të tipit të përzier, që as nuk është krejtësisht tradicionale e as krejtësisht digjitale. Në gjuhën e bibliotekave, këto biblioteka shpesh njihen si 'biblioteka hibride', që janë rezultat i zhvillimit të shërbimeve të bibliotekave tradicionale duke shfrytëzuar teknologjinë e komunikimit dhe të informacionit.

Mirëpo, kur në një bibliotekë dominojnë më shumë shërbimet digjitale, përfshirë edhe koleksionet digjitale, apo kur bibliotekat krijojnë veçmas biblioteka të mbështetura pothuaj krejtësisht në koleksione e shërbime digjitale, atëherë kemi të bëjmë me biblioteka digjitale, siç është rasti i Bibliotekës Digjitale të Botës (World Digital Library), Kujtesës Amerikane të Bibliotekës së Kongresit, Bibliotekës Gallica të Bibliotekës Kombëtare të Francës (Gallica), Bibliotekës Europeana të Evropës (Europeana), etj.

Në vazhdim po jap shkurtimisht disa aspekte të bibliotekave digjitale, që mendoj se duhet të kihen parasysh me rastin e ndërtimit të suksesshëm të një biblioteke digjitale. Megjithatë, ato paraqesin mendime personale, por që mund të nxisin të menduarit dhe të reflektuarit për një bibliotekë digjitale plot-funksionale. Duhet theksuar se renditja e aspekteve në vijim nuk paraqet ndonjë rëndësi për njërën apo tjetrën, për shkak se secila përbën një domosdoshmëri në vetvete në kontekstin e bibliotekave digjitale.

Teknologjia. Është një ndër komponentët thelbësore të bibliotekave digjitale. Në fund të fundit, teknologjia mundëson që një bibliotekë të quhet digjitale. Ajo përfshin, si programet apo softuerët e hapur dhe komercial për platformën e bibliotekës digjitale, si Greenstone, DigiTool, etj., dhe një varg programesh e aparatesh të tjera në mbështetje të tyre, si kompjuterë, serverë, rrjet të internetit, uebsajt me veçoritë të ndryshme si ato të ueb 2.0, të cilat mundësojnë përfshirjen aktive të përdoruesve, pastaj skaner me softuer përcjellës, etj. Të gjitha këto duhet të jenë të përshtatshme, pra ndëroperacionale, me teknologjitë dhe sistemet në zhvillim që të sigurohet jetëgjatësia e bibliotekës digjitale si tërësi.

Personeli. Si çdo bibliotekë tradicionale, edhe biblioteka digjitale mbështetet në burimet njerëzore. Kryesisht, dallohen dy kategori të personelit, ai teknik dhe ai profesional. Personeli profesional bën rregulloret e pasurimit me koleksione, cilësisë së tyre, ofrimin e shërbimeve të ndryshme, lidhë bashkëpunime të ndryshme, etj. Ndërsa, personeli teknik merret me administrimin teknologjik të bibliotekës digjitale dhe zbatimin e të gjitha rregulloreve të bëra nga personeli profesional.

Ndonëse mund të thuhet se një bibliotekë digjitale është si një lloj vetëshërbimi, pasi përdoruesi ka mundësi të kërkoj, gjejë, shkarkojë, ruaj e dërgoj dikujt tjetër burime digjitale, personalizoj shërbime, manipulojë me informacionin, shton metadata, anoton, ndërton bibliografi personale, etj., prapë se prapë ekziston një mori punësh e veprimtarish që i mbështesin këto vetë-shërbime, e për të cilat kujdeset personeli profesional dhe teknik.

Qeverisja/administrimi. Ky është një aspekt tejet i rëndësishëm që do shqyrtim që në fillimet e planifikimit të ndërtimit të një biblioteke digjitale. Ndonëse jo gjithçka mund të qartësohet që në fillim, duhet të përvijohen vija të qarta të qeverisjes së bibliotekës digjitale. Në këtë kuadër hyn struktura e menaxhimit dhe vija e raportimit, rolet e bibliotekarëve, rolet e personelit tjetër administrativ. A të jetë qeverisja e bibliotekës digjitale e shpërndarë dhe e integruar në tërë veprimtarinë e punës së bibliotekës tradicionale në të cilën krijohet bibliotekat digjitale, apo të jetë e konsoliduar rreth një departamenti në vete? A duhet të qeveriset bashkë me partnerët e tjerë në rast bashkëpunimi, apo duhet të jetë e centralizuar? Këto janë vetëm disa pyetje që i parashtroj dhe për të cilat nuk ka një përgjigje të vetme të saktë, por opsione dhe mundësi të ndryshme të qeverisjes së bibliotekave digjitale.

Zhvillimi i Koleksioneve. Koleksionet paraqesin bërthamën e bibliotekës digjitale. Pa to nuk do të kishte kuptim asnjë prej përpjekjeve, shërbimeve, teknologjive moderne të zbatuara dhe as personeli i përfshirë. Meqë rëndësia e tyre është thelbësore, edhe kujdesi për to duhet të jetë thelbësor. Sipas mendimit tim, një bibliotekë digjitale e bënë të pasur disa veçori të koleksioneve të saj, si:

- Cilësia, që zakonisht monitorohet përmes një programi të mirëfilltë të zhvillimit të koleksioneve dhe menaxhimit të tyre, përfshirë kriteret e përzgjedhjes sipas misionit të bibliotekës dhe nevojave të përdoruesve që përfshijnë mbulimin e fushave të ndryshme të dijes;

- Sasia, që po ashtu tregon se sa e përkushtuar është një bibliotekë për t'ju ofruar përdoruesve të saj informacione;
- Organizimi, që kanë të bëjnë me pasurimin me metadata, të qenit ndëroperacional me të gjitha protokollet dhe standardet ndërkombëtare të bibliotekave dhe teknologjive të informacionit, mundësia e kërkimit dhe qasjes, mundësia e organizimit logjik, tematik, kronologjik, në bazë të formateve, etj., nga vet përdoruesi;
- Formatet dhe llojet, që kanë të bëjnë me llojshmërinë e dokumenteve, si: .pdf, .jpg., video, audio, tekst, fotografi, etj., që u përshtaten nevojave të përdoruesve, përfshirë edhe të atyre me nevoja të veçanta;
- Ruajtja afatgjate, që përfshin vetë dokumentin dhe lidhjet e tij;
- Shërbimet, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me dokumentet, si ruajtja, dërgimi me postë elektronike, përkthimin në gjuhë të ndryshme, dhe manipulimet e tjera në përgjithësi.

Ruajtja dhe Konservimi. Paraqet një botë mbase më të ndërlikuar të ruajtjes, konservimit dhe shërimit të dokumenteve digjitale në krahasim me dokumentet tradicionale në letër. Vështirësitë paraqiten në ruajtjen e dokumentit dhe formës së tij të përgjithshme, formatit të tij, vargut të informacionit (bitëve dhe bajtëve), apo edhe të teknologjisë së përfshirë në leximin, përpunimin, manipulimin dhe shfaqjen e atij dokumenti. Pra, kemi nivele të ndryshme të ruajtjes së informacionit që shpeshherë kërkon përkthimin, konvertimin dhe shndërrimin nga një format në tjetrin. Në të shumtën e rasteve, kjo nënkupton ruajtjen e informacionit, por jo edhe të paraqitjes dhe dukjes në formë të dokumentit origjinal. Në bibliotekat digjitale bëhen përpjekje të ruhet gjithnjë një kopje kryesore (origjinale) e dokumentit në një format të caktuar, që zakonisht është në TIFF, dhe kopje të tjera në formate të ndryshme, të cilat mund të manipulohen për t'ju përshtatur nevojave të ndryshme të përdoruesve.

Nëse në zhvillimin e teknologjive, softuerëve dhe platformave të tjera digjitale arrihet të respektohen standardet ndërkombëtare, arrihet të stabilizohet struktura bazë e formateve të fajllave (dokumenteve) dhe teknologjisë, dhe krijohen procedura të qarta për ruajtjen e informacionit me pajtim të kompanive mbizotëruese në treg, vetëm atëherë mund të flasim për jetëgjatësinë e dokumenteve digjitale në bibliotekat e këtij tipi. Përderisa kjo nuk duket në horizont, dokumentet digjitale kërkojnë një përkujdes të vazhdueshëm, ndoshta edhe shumë më të kushtueshme se materialet e shtypura. Një përkujdes i shtuar duket të jetë praktika më e nevojshëm në realitetin e tanishëm të zhvillimeve dhe zbulimeve të teknologjisë informative.

Praktika e deritanishme në bibliotekat tradicionale ka treguar se jo gjithmonë në to hyjnë dhe ruhen të gjitha veprat dhe doreshkrimet e një populli, po flas në aspektin kombëtar. Po ashtu edhe në bibliotekat digjitale, gjithsesi, do të mbesin jashtë tyre vepra e dokumente me vlerë të cilat për një arsye ose tjetër mbesin nëpër kompjuterë personal të autorëve, krijuesve, inxhinierëve, producentëve, të një kombi. Jetëgjatësia e atyre dokumenteve, për fat të keq, mund të përfundojë me rastin e ndryshimit të formatit ose teknologjisë softuerike dhe harduerike. Një shembull krejt të freskët që secili prej nesh e ka mbërritur është ruajtja e dokumenteve në flopi disqe. Tani kompjuterët vijnë pa një lexues të tillë. Në një kohë jo të largët do t'i konsiderojmë, me terma abstrakt, ato dokumente "të humbura".

I preka në mënyrë të përgjithësuar këto tema të ruajtjes për të tërhequr vëmendjen e nevojës së planifikimit që në fillim të krijimit të bibliotekës digjitale sa u përket formateve të dokumenteve që duhet të zbatohen, strategjisë së ruajtjes afatgjate që duhet të përpilohet, kushtimit të vëmendjes për gjuhën me të cilat janë ndërtuar softuerët, si dhe përcjelljes së zhvillimit të teknologjisë harduerike në përgjithësi.

Financimi. Një aspekt të fundit por që meriton kujdes tejet të shtuar është edhe financimi apo sigurimi i fondeve. Ekzistojnë modele të ndryshme të financimeve, si: përmes projekteve të ndryshme të brendshme e të jashtme, financimeve të jashtme afatmesme dhe afatgjata, bashkëpjesëmarrje në projekte të përbashkëta që nganjëherë rezultojnë me ndihma financiare, përmes fondacioneve të ndryshme, etj. Megjithatë, më kryesorja nga të gjitha është që financimi i bibliotekës digjitale të një institucioni të caktuar të planifikohet të hyjë në vijën buxhetore të tij. Po ashtu, në financimin e një biblioteke digjitale është me rëndësi të kihen parasysh të gjitha aspektet dhe aktivitetet e saj, e jo të financohet vetëm një pjesë e saj.

Krejt në fund, krijimi i bibliotekave digjitale në Kosovë në nivel kombëtar dhe lokal do të fuqizonte pozicionin e bibliotekave të Kosovës brenda dhe jashtë vendit, duke ofruar shërbime më të shpejta dhe më të larmishme në mënyrë që të kemi qytetarë të informuar, të kemi një shoqëri demokratike të mbështetur në dije, gjithnjë duke ruajtur vlerat dhe trashëgiminë e shkruar dhe intelektuale të dokumentuar në formë digjitale. E ardhmja arrihet duke ndërtuar të sotmen. Dhe, e ardhmja e bibliotekave është profilizimi kah bibliotekat digjitale. Për të përfunduar këtë kumtesë me një slogan të përfolur në Konferencën e 75-të të IFLA-s në Milano të Italisë se "E ardhmja është tani".

DIGJITALIZIMI DHE NDIKIMI I TIJ NË KOLEKSIONET E VEÇANTA

Fahrije Simnica - Berisha

(Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës)

Sot nëpër institucione të Kosovës ruhen vlera kulturore dhe historike, shumica prej tyre kanë rëndësi kombëtare dhe një numër jo i vogël me rëndësi ndërkombëtare. Shumica e këtyre vlerave mbesin të njohura vetëm për një grup të ngushtë të njerëzve për shkak të mënyrës tradicionale të qasjes. Zgjidhje për këtë çështje sot ofron teknologjia bashkëkohore që mundëson ruajtjen dhe mbrojtjen efikase të kësaj pasurie si dhe qasje më të gjerë dhe më të lehtë për përdoruesit dhe sistematizim më të mirë të tyre. Një prej fushave me rëndësi ku teknologjia e re vjen në shprehje është DIGJITALIZIMI.

Viteve të fundit ka pasur diskutime rreth së ardhmes së Bibliotekës në epokën digjitale. Ende nuk janë definuar konceptet themelore të bibliotekës së ardhme elektronike Kombëtare përkundër kësaj disa Biblioteka Kombëtare kanë filluar ndërtimin e koleksioneve digjitale.

Sipas shpejtësisë së zhvillimit të bibliotekës digjitale , shtrohet pyetja edhe e mbijetesës së bibliotekës tradicionale. Disa studiues besojnë se bibliotekat e tanishme (tradicionale) do të zhduken si hapësira fizike , dhe se do të zëvendësohen me biblioteka virtuale në të cilat qasja në to do të jetë e mundur 24 orë në ditë përmes rrjetit elektronik.

Grupi i dytë i studiuesve mendon se bibliotekat do të mbesin ashtu siç janë sot, se influenca, ndikimi i gjithë kësaj teknologjie të re është vetëm një hap në zhvillim e cila më vonë do të zëvendësohet me një teknologji të re.

Grupi i tretë i studiuesve mendon se biblioteka si hapësirë fizike do të mbetet, por është e pashmangshme dhe urgjentisht duhet të kyçemi në procesin e transformimi për shkak të zhvillimit të teknologjisë së re dhe magjistrales së informacioneve. Mendoj se qëndrimi i tretë është më real, pra se duhet kyçur teknologjinë e re në biblioteka por duke lënë vend edhe për mënyrën tradicionale të qasjes. Këtë të ardhme duhet ta pranojmë me realizëm dhe guxim duke përshtatur digjitalizimin fondit dhe nivelit të zhvillimit të bibliotekarisë së Kosovës si dhe duke kuptuar se duhet të ecim në hap me kohën. P.sh. autori Prajs Ketlin në një artikull shkruan se "Bibliotekat do të bëhen arkiva të librave të cilat nuk kanë rëndësi të mjaftueshme që të jenë të kyçura në bazën e të dhënave".

Bibliotekat Kombëtare nëpër botë, si ajo e Kongresit në Washington, ajo e Britanisë së Madhe në Londër dhe Biblioteka Kombëtare e Francës në Paris, kurë bëhet fjalë për procesin e zhvillimit të bibliotekës elektronike këtë zhvillim këto Biblioteka e kanë përcaktuar në tri fusha:

1. Zhvillimin e katalogut elektronik si zhvillim i informacionit;
2. Zhvillimi i koleksioneve digjitale si informata primare;
3. Zhvillim i koleksioneve të CD-ve.

Përparësitë e botimeve elektronike janë të mëdha. Bibliotekat digjitale mund të lidhen shumë lehtë me burimet e cilësdo bibliotekë digjitale. Në këtë rrugëtim duhet pasur parasysh ballafaqimin me probleme të vështira si p.sh. rreth së drejtës së autorit.

Disa pyetje bazë që parashtrohen rreth digjitalizimit janë:

Cilat dokumente do të digjitalizohen? Cilat rezultate të dëshirueshme do të arrihen? Cilat probleme në mënyrë të pashmangshme do të na paraqiten gjatë procesit të digjitalizimit?

Është e nevojshme të kemi standarde/rregulla të njëjta sa i përket të drejtës intelektuale/të drejtës së autorit. Sot bibliotekat kanë të drejtë që ti fotokopjojnë materialet vetëm për përdorim, për mbrojtje dhe konservim si dhe që kopja t'iu jepet bibliotekave të tjera. Të drejtën për distribuim të mëtutjeshëm të dokumenteve e kanë botuesit dhe autorët.

Kurë bëhet fjalë për dokumentet elektronikë, çështja e mbrojtjes është shumë më e ndjeshme se sa kur kemi të bëjmë me ato të shtypura - brenda dokumentit elektronik shumë më lehtë mund të bëhet ndërrimi i titullit, autorit dhe përmbajtjes. Të gjitha këto janë pyetje komplekse ku ekspertet duhet të gjejnë një zgjidhje.

Për këtë Komisioni Evropian ka hartuar dokumentin për të drejtat e autorit në botën elektronike që iu ka lënë në dispozicion të gjitha institucioneve që janë të interesuara.

Shumë biblioteka në botë e kanë hartuar projektin për digjitalizimin e Bibliotekës.

Ndër projektet më të mëdha që e pret BKUK-në në të ardhmen është digjitalizimi i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Në digjitalizimin e BKUK-së do të ndeshen

synimet tona që të ofrojmë kualitet sa më të mirë në mediumet bashkëkohore dhe të dalim përballë kërkesave të reja të përdoruesve që ta rritim shkallën dhe standardin e përshtatjes së resurseve informative të cilat ne i posedojmë.

Digjitalizimi i BKUK-së do ta përfaqësonte institucionin virtual paralel të bibliotekës klasike pa mure. Kjo do ta shpinte përdoruesin deri te informatat e dëshirueshme jo vetëm te katalogu publik po edhe te përmbajtja e librit e më tej deri te versioni digjital i faqeve të librit, shënimeve audio (me zë) apo të fotografive (përparësitë e bibliotekës digjitale).

Një prej sfidave për BKUK-në sot është nevoja për të vënë në internet trashëgiminë tonë kombëtare dhe kjo për dy qëllime:

A) Për të arsimuar qytetarët tonë dhe për të ofruar qasje edhe për individë/studiues nga vendet e tjera, si dhe;

B) Për të promovuar kulturën dhe identitetin tonë (të Kosovës).

Procesi i krijimit të bibliotekës digjitale përfshinë shumë aktivitete. Së pari është e domosdoshme që të bëhet përzgjedhja e një pjese të koleksionit në varësi nga synimi ynë se çka ne dëshirojmë që të realizojmë gjatë procesit të digjitalizimit.

Sa i përket koleksioneve të veçanta, që janë mjaft të pasura në BKUK, shpeshherë dokumentet janë të formatit të madh, në gjendje të keqe fizike dhe shumë komplekse që dallojnë nga tekstet e zakonshme. Ne si BKUK duhet të hartojmë projekte për digjitalizimin e fondit të veçantë. Kriter për përzgjedhje, pra përparësi në digjitalizim, duhet të jetë vlera kulturore-historike e atij materiali për Kosovën.

Nga praktika, sot në botë lloji i dokumenteve që më së shpeshti digjitalizohen janë librat e rralla (49%), fotografi (44%) , dorëshkrimet (39%), monografitë (35 %), muzikalet (30%), gazetat (9%), hartat (1%).

Bibliotekës Kombëtare i duhen resurse të mëdha duke filluar nga stafi i trajnuar posaçërisht dhe pajisjet teknike e mjetet e tjera lehtësuese. Kjo është e kuptueshme nëse dihet se pothuajse çdo bibliotekë Kombëtare në vendet në zhvillim kërkon përkrahje nga jashtë nga organizatat ndërkombëtare, OJQ madje edhe nga sektori privat për të përballuar barrën e digjitalizimit.

Prioritet duhet të kenë zona e cila më së shpeshti konsultohet, dokumentet që janë në gjendje të keqe, si dhe ato që janë më të rëndësishme për historinë dhe kulturën e vendit.

Prandaj materialet/dokumentet që duhet të digjitalizohen në fillim janë:

1. Materiali i cili shumë kërkohet, por që për momentin është i papërshtatshëm për përdorim;
2. Periodiku i vjetër dhe mikrofilmat (p.sh. "Dielli");
3. Materiali me vlera ku kërkesat për të janë të mëdha.("Hylli i Drites", "Albania" e Konicës);
4. Librat historikë dhe dorëshkrimet (gjuhën osmane dhe arabe).

Në fund mund të thuhet se në botë tash për tash nuk ekziston një model i vetëm në ndërtimin dhe menaxhimin e bibliotekës digjitale, si dhe nga ana e zgjedhjes së materialeve për digjitalizim, në aspektin e procesit teknologjik, metodës së ndërtimit dhe të ruajtjes së koleksioneve digjitale. Standardet digjitale ndryshojnë në raporte me llojin e dokumentit i cili digjitalizohet si dhe kërkesat që mund të ketë vetë biblioteka.

Siç po shihet biblioteka digjitale do të përcaktojë një mision të ri për specialistët e bibliotekave dhe do të ndikojë në zgjerimin e rolit të tyre në përzgjedhjen e resurseve të rëndësishme për përdoruese dhe në lehtësimin e qasjes në këto resurse.

Lirshëm mundë të themi se për bibliotekën digjitale kërkohen specialistë për digjitalizim të cilët do të jenë në gjendje që t'i udhëzojnë përdoruesit digjitalë në përdorimin e fondeve digjitale. Përdoruesve duhet t'u sigurohet në të njëjtën kohë qasje në burime heterogjene të informacionit si në ato lokale edhe në ato më të largëta.

Përmes bibliotekës digjitale një pjesë e pasurisë sonë kulturore historike do të bëhet pjesë e pasurisë kulturore botërore në formë të digjitalizuar.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR SHKËMBIMIN E SHTYPIT

Tiranë (Shqipëri), 25 qershor 2009

Drejtori i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë - Aurel Plasari dhe drejtori i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës - z. Sali Bashota, nënshkruan, më 25 qershor 2009, në Tiranë, marrëveshjen e bashkëpunimit për shkëmbimin e shtypit (gazeta dhe revista) të botuar në Shqipëri dhe Kosovë.

Kjo marrëveshje vjen në mbështetje të Marrëveshjes dypalëshe kulturore të Autoriteteve Eprore, nën të cilat BKSh dhe BKUK ushtrojnë veprimtarinë e tyre, dhe ka për synim informimin e lexuesve të të dyja vendeve me shtypin përkatës, si dhe formimin e koleksioneve të kujtesës kombëtare në mënyrë reciproke.

Në ceremoninë e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje morën pjesë edhe përfaqësues të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Shqipërisë dhe përfaqësues të mediave të Shqipërisë.

Të dy bibliotekat synojnë krijimin e një rrjeti të përbashkët të informacionit bibliografik.

Marrëveshja u mirëprit edhe nga pjesëmarrës në këtë ceremoni - z. Remzi Lani, drejtor i Institutit të Medias dhe z. Aleksandër Çipa, kryetar i Unionit të Gazetarëve të Shqipërisë.

Në shkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit midis BKUK-së dhe BKSh-së

BKUK - NJË NGA THEMELUESIT E UNIONIT TË BIBLIOTEKAVE TË BALLKANIT

Edirne (Turqi), 29 korrik 2009

Më 29 korrik 2009, në Edirne të Turqisë, u themelua Unioni i Bibliotekave të Ballkanit. Themelues të Unionit janë: Biblioteka Qendrore e Universitetit të Trakisë në Edirne (Turqi), Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës në Prishtinë (Kosovë), Biblioteka Universitare në Sofie (Bullgari), Biblioteka Universitare në Rumani, Biblioteka Universitare Shtetërore në Sofie (Bullgari), Biblioteka Universitare në Tuzëll (Bosnjë dhe Hercegovinë), Biblioteka Universitare në Beograd (Serbi), Shoqata e Bibliotekarëve të Turqisë, Biblioteka Universitare e Universitetit Marmara në Stamboll (Turqi).

Përfaqësues nga Kosova në këtë solemnitet të themelimit të Unionit të Bibliotekave të Ballkanit ishin: Prof. dr. Mujë Rugova Rektori i ri i Universitetit të Prishtinës, i cili ishte ftuar nga Rektori i Universitetit të Trakisë Prof. dr. Enver Duran, pastaj Prof. dr. Sali Bashota, drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Besim Kokollari, kryetar i Shoqatës së Bibliotekarëve të Kosovës.

Unioni i Bibliotekave të Ballkanit mbajti takimin e parë të Kuvendit Zgjedhor ku u miratua statuti i këtij Unioni dhe u zgjodh me votë të fshehtë Bordi Ekzekutiv dhe Udhëheqësia e parë me mandat trevjeçar. Kryetar i Unionit të Bibliotekave të Ballkanit u zgjodh Ender Bilar, drejtor i Bibliotekës Qendrore të Universitetit të Trakisë (Turqi), Nënkryetar i parë Prof. dr. Sali Bashota, drejtor i BKUK-së (Kosovë), Nënkryetar i dytë Prof. dr. Gilda Draganescu (Rumani) dhe Sekretar i përgjithshëm Prof. dr. Tuba Karatepe (Turqi).

Themelimi i këtij Unioni ka për qëllim të krijojë një rrjet funksional të bashkëpunimit të bibliotekave në vendet e Ballkanit, të sigurojë mbështetje për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Ballkanit, si dhe të përmirësojë mundësinë e ofrimit të informacionit të koleksioneve e bibliotekave të Ballkanit.

Unioni i Bibliotekave të Ballkanit është i hapur për anëtarësi të bibliotekave, arkivave, institucioneve dhe shoqatave që kanë të bëjnë me librin dhe informacionin. Ky Union do të organizojë konferenca me karakter shkencor, simpoziume, seminare dhe aktivitete të tjera lidhur me zhvillimin e bibliotekave në përgjithësi.

Simpoziumi i parë shkencor me karakter ndërkombëtar i Unionit do të mbahet më 21-22 tetor 2010 në Edirne (Turqi), me temën bosht "Dokumentet Osmane për Edirnen në Arkivat e Ballkanit".

Unioni i Bibliotekave të Ballkanit, ku BKUK është një nga themeluesit, gjithsesi, hap një perspektivë të re në përfaqësimin e bibliotekave të Kosovës në institucionet ndërkombëtare të bibliotekave.

Gjithashtu, në një ceremoni të veçantë është bërë edhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bibliotekës Qendrore të Universitetit të Trakisë dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

BIBLIOTEKA KOMBËTARE NË SHTETIN E PAVARUR TË KOSOVËS

(Reagim zyrtar i delegacionit të Kosovës në Kongresin e IFLA-s)

Milano (Itali), 25 gusht 2009

Në Kongresin e 75-të të IFLA-s (Federata Ndërkombëtare e Asociacioneve dhe Institucioneve Bibliotekare) që është mbajtur në Milano të Italisë, më 24 gusht 2009, delegacioni nga Kosova i ka dërguan një reagim zyrtar Bordit udhëheqës të IFLA-s dhe Komitetit të FAIFE-së (Komiteti për Qasje të Lirë në Informacion dhe Liri të Shprehjes) lidhur me të pavërtetat e përfaqësuesve serbë në kumtesën e paraqitur në këtë Kongres para opinionit bibliotekar ndërkombëtar.

Në reagimin e përfaqësuesve të Kosovës, thuhet:

Autorët serbë Gordana Stokiq Simonçiq dhe Zoran Vukadinoviq, të cilët e paraqitën kumtesën e tyre me titull "Libri dhe bibliotekat serbe në Kosovë dhe Metohi", në sesionin e Historisë së Bibliotekave në Kongresin e 75-të të IFLA-s në Milano, sollën para opionionit bilbiotekar ndërkombëtar dezinformata dhe të pavërteta të shumta, që kanë të bëjnë me librin dhe bibliotekat në Kosovë.

- Autorët e kësaj kumtese, fatkeqësisht, ende pretendojnë se Kosova është territor i Serbisë, ndërkaq, dihet fakti se Kosova është shtet i pavarur dhe i njohur ndërkombëtarisht.
- Autorët e kësaj kumtese dezinformojnë opinionin se gjoja: "Sot nuk ka komb evropian, bibliotekat e një pjese të territorit të së cilit janë më në rrezik sesa koleksionet e librave serb në Kosovë...", ndërsa e vërteta për këtë çështje është ndryshe. Të gjitha fondet dhe koleksionet e librit serb në Kosovë, si në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe në bibliotekat e tjera të Kosovës janë ruajtur, mirëmbajtur, përpunuar dhe shfrytëzuar si të gjitha koleksionet e tjera bibliotekare. Ndërkaq, në periudhën 1991-1999 në Kosovë, pikërisht regjimi serb i Millosheviqit ka djegur, shkatërruar e asgjësuar me mijëra libra në gjuhën shqipe. Vetëm në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, pa i numëruar bibliotekat e tjera të djegura e të shkatërruara anë e kënd Kosovës, sipas raporteve vendore dhe ndërkombëtare, janë dërguar dhe asgjësuar mbi 100 000 ekzemplarë librash në fabrikën e letrës në Lipjan afër Prishtinës.
- Autorët e kësaj kumtese, gjithashtu, japin informata të pasakta lidhur me historinë e Kosovës, duke falsifikuar të dhëna të shumta për trashëgiminë kulturore, institucionet arsimore dhe kulturore, institucionet e kultit, etj.
- Autorët e kësaj kumtese spekulojnë opinionin lidhur me themelimin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Madje, marrin edhe guximin të japin dezinformata se gjoja qeveria e Serbisë e ka themeluar këtë institucion. Dihet fakti se Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës është themeluar nga Kuvendi i Kosovës.

Më tutje, ata e anashkalojnë qëllimisht periudhën e viteve 1990-1999, ku regjimi serb i Millosheviqit ka bërë okupimin klasik të institucioneve arsimore, kulturore, shkencore, etj. Në këtë periudhë punëtorët shqiptarë u dëbuan me dhunë nga puna, si në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, ashtu edhe bibliotekat e tjera, që rezultoi në administrimin e tyre nga personeli serb. Prandaj, pos që nuk është bërë pasurimi i fondeve me librin shqip në biblioteka për një periudhë 10-vjeçare, në mënyrë sistematike është bërë shkatërrimi i koleksioneve bibliotekare. Për më tepër, gjatë periudhës së luftës në Kosovë 1998-1999, ndërtesa e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare e Kosovës është përdor si bazë ushtarake e ushtrisë serbe.

Këto dezinformata tejet qëllimkëqija, të njëanshme dhe të motivuara politikisht, që kanë të bëjnë me librin dhe bibliotekat në Kosovë, ku trajtohen veçmas koleksionet e librit serb, gjithsesi paraqesin spekulime të llojit të vet që i bëjnë këta dy autorë.

Opinioni ndërkombëtar e di qartë se kush ka shkatërruar, asgjësuar dhe djegur në Kosovë. Prandaj, dëshmitë për shkatërrimin e trashëgimisë kulturore në Kosovë, përfshirë librin, bibliotekat, arkivat, insituticonet e kultit, etj., janë të njohura, si përmes raportit të IFLA/FAIFE-së të botuar në prill të vitit 2000, ashtu edhe përmes raportit "Case No. IT-02-54-T, të paraqitur hetuesisë së Tribunalit të Hagës, me rastin e gjykimit të Millosheviqit, si edhe të shumë raporteve, analizave dhe hulumtimeve të tjera lidhur me këto çështje.

Në çdo shoqëri demokratike duhet të respektohen mendimi dhe fjala e lirë. Megjithatë, kur paraqiten si tendencioze, qëllimkëqija, të pasakta, dhe ku sulmohet kultura dhe civilizimi i një populli, prezantimet e tilla, siç është rasti me kumtesën e dy autorëve serbë, janë më shumë se të dëmshme.

Shpresojmë dhe besojmë se ky reagim yni do të shqyrtohet nga instancat e larta të IFLA-s dhe të jetë i njohur për opionin e gjerë bibliotekar.

BKUK NË KONGRESIN E 75-TË I IFLA-s

Milano (Itali), 25 gusht 2009

Përfaqësuesit e institucioneve të Republikës së Kosovës, dr. Sali Bashota, drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, Sami Piraj, drejtor i Departamentit të Kulturës në Ministrinë e Kulturës dhe Besim Kokollari, kryetar i Shoqatës së Bibliotekarëve të Kosovës, të cilët me ftesë zyrtare po marrin pjesë në Kongresin e 75-të të IFLA-s (Federata Ndërkombëtare e Asocacioneve dhe Institucioneve Bibliotekare) që po mbahet në Milano të Italisë, më 24 gusht 2009 patën takim zyrtar me Ingeborg Verheul, drejtoreshë për Komunikim dhe Anëtarësim në IFLA.

Në këtë takim është diskutuar lidhur me kërkesën e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Shoqatës së Bibliotekarëve të Kosovës për anëtarësim të rregullt në këtë organizatë. Siç dihet, kërkesa për anëtarësim të institucioneve i është bërë Bordit udhëheqës të IFLA-s vitin e kaluar gjatë takimit të Kuvendit të përgjithshëm të saj të 74-të të mbajtur në Quebec të Kanadasë. Sipas zyrtares së lartë të IFLA-s, institucionet bibliotekare të Kosovës i plotësojnë të gjitha kriteret për të qenë anëtarë të rregullt të IFLA-s, përveç kodit të vendit, për të cilën çështje është kompetente organizata ISO (Organizata e Stanadardeve Ndërkombëtare).

BKUK PRANOHET NË KONFERENCËN E DREJTORËVE TË BIBLIOTEKAVE KOMBËTARE

Milano (Itali), 26 gusht 2009

Në kuadër të programit të Kongresit të 75-të të IFLA-s që është mbajtur në Milano të Italisë, në takimin e radhës së Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare nga e mbarë bota, në mesin e 133 shteteve anëtare të Konferencës së Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare, nga 26 gusht 2009 u bë anëtare e rregullt e kësaj Konference edhe Biblioteka Kombëtare dhe Univeristare e Kosovës, që përfaqësohet nga drejtori i saj dr. Sali Bashota.

Konferenca e Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare (CDNL) është asociacion i pavarur i Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare nga e mbarë bota, e themeluar të avancojë dhe të promovojë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në çështje të interesit të përbashkët në shumë fusha që kanë të bëjnë me librin dhe bibliotekat. Drejtorët e Bibliotekave Kombëtare takohen për çdo vit gjatë punimeve të Kongresit të IFLA-s.

Konferenca e Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare (CDNL) ka për vizion krijimin dhe zhvillimin e një biblioteke digjitale globale, e cila do të mund të shfrytëzohet gjerësisht dhe pa kufizime përmes internetit nga përdorues të mbarë botës, duke ofruar qasje në materialet dhe koleksionet e të gjitha bibliotekave kombëtare në interes të hulumtuesve, studiuesve, të zhvillimit ekonomik, arsimor dhe të avancojë mirëkuptimin ndërkombëtar përmes formave të ndryshme të integrimeve kulturore dhe intelektuale.

Anëtarësimi në këtë asociacion më të lartë të Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare të botës është një sukses tjetër i ri i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në nivelin ndërkombëtar. Gjithsesi, kjo arritje kontribuon edhe në afirmimin dhe zhvillimin e bibliotekarisë së Kosovës në përgjithësi.

Besim Kokollari

Drejtorët e bibliotekave të botës në takimin vjetor të Konferencës së Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare të Botës në Milano

MARRËVESHJE MIDIS BKU TË KOSOVËS DHE BKU TË KROACISË

Prishtinë, 7 Tetor 2009

Drejtori i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës Prof.Dr. Sali Bashota dhe drejtori Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kroacisë Prof. Dr. Tihomil Maštrović nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit në mes të dy Bibliotekave Kombëtare.

Kjo marrëveshje parasheh bashkëpunim midis dy bibliotekave në nivele të ndryshme profesionale, siç janë: shkëmbimi ndërkombëtar i botimeve, huazimet ndërkombëtare ndërmjet bibliotekave, pastaj shkëmbimi i ndërsjellë i përvojave profesionale, informatave dhe i arritjeve shkencore në fushat me interes të veçantë, si: grumbullimi i fondeve, lejimi i botimeve të huaja që i përkasin atij vendi, ekspozita të përbashkëta dhe aktivitete tjera nga fusha e bibliotekarisë. Rol të veçantë në këtë Marrëveshje ka zënë edhe shkëmbimi i specialistëve në suazat e limiteve të caktuara vjetore, me qëllim të trajnimit të stafit profesional bibliotekar, pastaj shkëmbimit të përvojave në fushën e teknologjisë informative si dhe shkëmbimit të përvojave në restaurimin dhe konservimin e materialeve bibliotekare.

Prof. Dr Tihomil Maštrović dhe Prof. Dr. Sali Bashota, gjatë ceremonisë së nënshkrimit të Marrëveshjes

Në ceremoninë e nënshkrimit të Marrëveshjes, morën pjesë edhe Ambasadori i Kroacisë në Kosovë - z. Zllatko Kramarić si dhe Ministri i Kulturës Rinisë dhe Sporteve të Kosovës - z. Valton Beqiri.

Drejtori Maštrović gjatë dy ditë qëndrimi në Kosovë është takuar edhe me ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - z.Valton Beqiri, me Rektorin e Universitetit të Prishtinës, Prof. Dr. Mujë Rugova dhe me Dekanin e Fakultetit të Filologjisë Prof. Dr. Osman Gashin.

BASHKËPUNIMI BIBLIOTEKAR KOSOVË - DANIMARKË

Kopenhagë (Danimarkë), 22 tetor 2009

Një delegacion nga Kosova, i udhëhequr nga dr. Sali Bashota, drejtor i Bibliotekës Kombëtare e Universitare të Kosovës dhe i shoqëruar nga dr. Ibrahim Berisha, këshilltar i Presidentit të Kosovës, Sami Piraj, drejtor i Drejtoratit për Kulturë në Ministrinë e Kulturës së Kosovës, dhe Ahmet Bella e Ramadan Reshitaj, anëtarë të kryesisë së Unionit të Shoqatave Shqiptare në Suedi, kanë zhvilluar një takim zyrtar me udhëheqjen e Bibliotekës Mbretërore të Danimarkës.

Dr. Greta Jacobsen dhe dr. Knud Arne Jurgensen, drejtues të Bibliotekës Mbretërore daneze, kanë informuar delegacionin kosovar me zhvillimet historike dhe aktuale të kësaj biblioteke, e cila funksionon që nga shekulli XVI dhe aktualisht ka një fond prej mbi 30 milionë ekzemplarë librash e njësish bibliotekare. Në fondin e kësaj biblioteke janë edhe 142 tituj librash në gjuhën shqipe dhe një dokumentacion i vlefshëm për historinë, letërsinë, kulturën dhe traditën shqiptare.

Delegacioni nga Kosova dhe mikpritësit danezë janë dakorduar që të thellojnë bashkëpunimin e ndërsjellë. Ata kanë biseduar edhe për shkëmbimin e botimeve në mes të dy vendeve dhe për shtimin e përkthimeve të veprave daneze në gjuhën shqipe si dhe të veprave të shkrimtarëve shqiptarë në gjuhën daneze.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, do të realizohet edhe një vizitë e përfaqësuesve të Bibliotekës Mbretërore Daneze në Kosovë.

Izet ABDYLI

SONJA BISERKO I DHURON BKUK-së LIBRA PËR TË DREJTAT E NJERIUT

22 qershor 2009, Prishtinë

Fondi i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës është pasuruar edhe me 135 libra nga fusha e të drejtave të njeriut nga autorë të ndryshëm serbë dhe shqiptarë, të cilat i ka dhuruar Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi.

Sonja Biserko, veprimtare për të drejtat e njeriut nga Serbia, ka sqaruar se këto janë botime që kanë dalë në këto 15 vitet e fundit dhe që kryesisht flasin për Serbinë gjatë viteve të luftës. "Ideja është që kjo të mbetet në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, në mënyrë që të gjithë ata që janë të interesuar të kenë mundësi të shohin atë, e cila në opinionin tonë është shumë e margjinalizuar. Sipas saj, bëhet fjalë për 135 publikime, që janë botuar në katër edicione. Një pjesë e këtyre librave përmban se çka ka ndodhur rreth gjykimit në Tribunalin e Hagës. Njëri nga librat përmban gjykimin e Sllobodan Millosheviqit, Vojisllav Sheshelit etj.

SEMINARI "BIBLIOTEKAT E KOSOVËS MIDIS TRADICIONALES DHE MODERNES"

3-4 shtator 2009, Prizren

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Biblioteka Ndërkomunale e Prizrenit, kanë organizuar në Prizren, më 3-4 shtator 2009, seminarin me temën: "Bibliotekat midis tradicionales dhe modernes".

Gjatë këtij seminari u mbajtën ligjërata që përkojnë me zhvillimet e shërbimeve tradicionale dhe moderne të bibliotekave në Kosovë. Një pjesë tjetër e sesioneve është përqendruar në probleme praktike në fushën e katalogimit të librit dhe të koleksioneve të veçanta - në format e ruajtjes, përpunimit dhe plasimit të informacioneve dhe koleksioneve në internet.

Gjatë dy ditëve të këtij seminari u paraqiten një numër i madh i kumtesave nga udhëheqës të bibliotekave dhe bibliotekarë. Drejtori i BKUK-së - Dr. Sali Bashota referoi në temën bosht të këtij seminari: "Bibliotekat e Kosovës midis tradicionales dhe modernes"; Sahadete Sadikaj, drejtoreshë e Bibliotekës Ndërkomunale të Prizrenit: "E kaluara dhe e ardhmja e bibliotekave të Kosovës"; Tahir Foniqi, shef i departamentit të Bibliografisë në BKUK: "Biblioteka universitare brenda kornizave tradicionale", Besim Kokollari, udhëheqës i programit Aleph në BKUK: "Aspekte të bibliotekave digjitale"; Prend Buzhalla, drejtor i Bibliotekës Komunale të Klinës: "Fondi i sektorit të vendlindjes në bibliotekat publike", Fahrije Simnica – Berisha, redaktore e Koleksioneve të Veçanta në BKUK: Digjitalizimi dhe ndikimi i tij në Koleksionet e Veçanta etj..

Pjesëmarrës të seminarit "Bibliotekat e Kosovës midis tradicionales dhe modernes"

Ky seminar ka pasur për qëllim ofrimin e informacioneve që kanë të bëjnë me gjendjen e bibliotekave të Kosovës në të kaluarën dhe në të tanishmen, si dhe orientimin i tyre kah modernizimi i shërbimeve sipas standardeve më të reja ndërkombëtare të bibliotekarisë, sidomos në kuadër të zhvillimit të teknologjisë së komunikimit dhe të informacionit.

Diana Topalli

NË GJAKOVË U INAUGURUA BIBLIOTEKA *"IBRAHIM RUGOVA"*

14 qershor 2009, Gjakovë

Në Gjakovë, më 14 qershor 2009, është inauguruar godina e bibliotekës së kësaj komune që mban emrin e ish-presidentit të Kosovës - Ibrahim Rugova.

Hapja solemne e kësaj biblioteke është bërë nga presidenti i vendit - dr. Fatmir Sejdiu, në praninë e familjes së ish-presidentit Rugova, si dhe të përfaqësuesve të lartë të Qeverisë së Kosovës dhe të komunës së Gjakovës.

Presidenti i Republikës së Kosovës në inaugurimin e Bibliotekës "Ibrahim Rugova"

Biblioteka "Ibrahim Rugova" ka një sipërfaqe prej 1.600 metra katrorë, me kapacitet prej 360 ulëseve për lexues brenda ditës dhe për më shumë se 600 shërbime të ofruara. Fondi i kësaj biblioteke përfshin mbi 28.000 ekzemplarë libra dhe materiale të tjera bibliotekare.

Biblioteka ka tri etazhe, ku janë të vendosura katër salla të leximit. Në brendi të saj ndodhet edhe salla universale për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme.

BKUK-së I DHUROHEN MATERIALE ME VLERË TË RËNDËSISHME KOMBËTARE

14 korrik 2009, Prishtinë

Jusuf Azemi, nënkryetar i organizatës "Balli Kombëtar"në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i njohur si veprimtar i madh i çështjes kombëtare, i ka dhuruar Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës 1064 ekzemplarë libra dhe materiale të ndryshme: 200 - libra, 378 ekzemplarë të gazetave, si dhe 486 ekzemplarë të revistave. Ndër librat e dhuruar, janë: "Kosova - djepi i shqiptarizmit" i autorit Hamit Kokalari, "Vendi që zë Skënderbeu në historinë e Shqipërisë" i Abaz Ermenjit, "Mallëngjimi" i Mit'hat Frashërit etj. Të rëndësishme për fondin e BKUK-së janë edhe gazetat dhe revistat "Përpjekja kosovare", "Vatra shqiptare", "Qëndresa", "Flamuri", "Besa" etj.

Jusuf Azemi

DITA NDËRKOMBËTARE E LIBRIT DHE E TË DREJTËS SË AUTORIT

23 prill 2009, Prishtinë

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka organizuar në Prishtinë një manifestim për në Ditën Ndërkombëtare të Librit dhe të Drejtës së Autorit. Me rastin e kësaj Dite kanë qenë të pranishëm nxënës, mësimdhënës, studentë, shkrimtarë, botues etj.

Me këtë rast janë dhuruan 99 libra për lexues moshash e profilesh të ndryshme. Libri i parë iu dhurua dr. Kenneth Oberembt, ish drejtor i BKUK-së (2002-2003) në shenjë nderimi për kontributin e tij dhënë bibliotekave në Kosovë.

Me shenjë të kësaj dite, u dhuruan donacione për themelimin e bibliotekë së shkollës fillore "Vëllezërit Frashëri" të Miradisë së Poshtme (Fushë Kosovë), për të cilën sipas Nazmi Rrahmanit, kryetari i Shoqatës së Botuesve të Kosovës, kanë dhuruar libra BKUK dhe Shtëpitë botuese: "Artini", "Libri shkollor", "Rozafa", "Elta", "Faik Konica" etj.

Bukurije Haliti

ROBERT L. MAXWELL, DORACAKU I MAKSWELLIT PËR AACR2 (QË SHPJEGON DHE ILUSTRON RREGULLAT ANGLO-AMERIKANE TË KATALOGIMIT - PËRMES AZHURIMIT 2003), SHOQATA AMERIKANE E BIBLIOTEKAVE, ÇIKAGO 2004, F. 626



I dizajnuar për të interpretuar dhe sqaruar AACR2, Doracaku i Maxwellit për AACR2 ilustron dhe aplikon rregullat më të fundit të katalogimit për shënimet MARC për të gjitha llojet e formateve të informacioneve. Duke u përqendruar në konceptin e integrimit të burimeve, ku informatat relevante mund të vihen në dispozicion në formate të ndryshme, botimi i rishikuar gjithashtu adreson Programin për Katalogim Bashkëveprues dhe nevojat e katalogimit të librave elektronikë dhe riprodhimeve digjitale të njësive fizike siç janë librat dhe hartat.

Korrigjimet e shumta kanë rezultuar në kapituj plotësisht të rishikuar që mbulojnë materiale hartografike, burime elektronike dhe burime të vazhdueshme apo botime serike. Nga librat dhe pamfletet deri te incizimet e zërit, muzika, dorëshkrimet, hartat e tjera, Doracaku i Maxwellit për AACR2 është udhëzuesi më gjithëpërfshirës dhe më i drejtpërdrejtë për interpretimin dhe aplikimin e rregullave standarde të katalogimit. Me një ilustrim prej më shumë se 490 figurash, që paraqesin të dhënat aktuale të katalogut në formatin MARC, ky botim i fundit është udhëzuesi thelbësor i rregullave të AACR2 për kataloguesit, instruktorët e katalogimit etj.

Ky libër u përkthye dhe u shtyp nga OSBE, si pjesë e projektit që plotëson nevojat e kataloguesve në Kosovë për përpunim e materialeve bibliotekare.

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË = LIBRARY WEEK IN KOSOVA : 14-18 PRILL = APRIL 2008, PRISHTINË, BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS, 2009, 176 F.

Ky botim i veçantë - i gjashti me radhë, është një përmbledhje punimesh fushash të ndryshme të prezantuara gjatë manifestimit Java e Bibliotekës në Kosovë 2008, në formë të punimeve të plota, disa nga këto shkrime, dhe në formë të abstrakteve, punimet e tjera. Këto shkrime u përkasin fushave të ndryshme nga bibliotekaria, që janë, njëkohësisht edhe preokupim i drejtuesve dhe punëtorëve të bibliotekave. Këto shkrime përfshijnë probleme të fushave teorike, por edhe probleme që kanë të bëjnë me kontekste dhe përvoja të drejtpërdrejta nga fusha e bibliotekarisë.

Ky botim përfshin ligjëratat, të cilat patën zgjuar interesim në opinionin kulturor bibliotekar, si ato të znj. Karen Coyle, konsultante për Bibliotekat Digjitale në Universitetin e Kalifornisë në SHBA: "Roli i bibliotekave në themelimin e SHBA-ve", "Bibliotekat digjitale - Si përdoren mënyrat digjitale për ruajtjen dhe katalogimin e librave të rrallë dhe të vjetër", "Sistemi i automatizuar bibliotekar", "Rrjeti si platformë - Bibliotekat Universitare (Modeli i Bibliotekës Amerikane, platforma e rrjetit)" etj.

Një pjesë e ligjëratave përfshijnë referimet me temën "Bibliotekat digjitale", që u mbajt në Prizren, ku referuan drejtues dhe bibliotekar që janë të lidhur ngushtë me preokupimet e modernizimit të bibliotekave nga Shqipëria dhe Kosova, si: Etleva Domi, Ramazan Vozga, Ramush Zeka, Gjon Berisha dhe Lavdije Rrahmani.

Ndërsa një seri tjetër e shkrimeve, me temën "Bibliotekaria në Kosovë"- e organizuar në Gjilan, përfshin probleme që lidhen me fushën e arsimimit të stafit të bibliotekave në Kosovë, ku kanë referuar drejtues nga Bibliotekat Ndërkomunale dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës: Shefki Osmani, Tahir Foniqi, Sahadete Sadikaj, Sylejman Pireva, Hajrullah Mustafa, Shqipe Asllani, Shkëndije Berisha, Xhemaledin Salihu dhe Avdi Lakna.

Bukurije Haliti